

**Tirana Bank SHA**

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare më dhe për  
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

## PERMBAJTJA

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	8
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	9
1 INFORMACION MBI BANKËN	10
2 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL	11
3. VLERËSIME DHE GJKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL	32
4 ADOPTIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA DHE INTERPRETIME	33
6 MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR	42
7 TË ARDHURA NGA INTERESI	62
8 SHPENZIME INTERESI	62
9 TË ARDHURA NETO NGA TARIFA DHE KOMISIONE	62
10 SHPENZIME PERSONELI	62
11 SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE	63
12 TATIMI MBI FITIMIN	63
13 MJETE MONETARE DHE LLOGARI ME BANKËN QENDRORE	66
14 HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT, NETO	69
15 AKTIVET FINANCIARE ME VLERËN E DREJTË PËRMES PASQYRËS SË TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE (VDPPAP)	80
16 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE TË INVESTUARA DHE TË RIPOSEDUARA	83
17 AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE	85
18 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE	86
19 AKTIVE TË TJERA	87
20 DETYRIME NDAJ BANKAVE	87
21 DETYRIME NDAJ KLIENTËVE	87
22 DETYRIME TË TJERA	88
23 PROVIJONE	89
24 KAPITALI I PAGUAR DHE PRIMI I AKSIONEVE	89
25 REZERVA TË TJERA	90
26 MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTET E TYRE	90
27 PALËT E LIDHURA	91
28 PARAQITJA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE SIPAS KATEGORIVE TË MATJES	92
29 ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA	93
30 NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	95

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Drejtuar Aksionarëve dhe Drejtimit të Tirana Bank SHA,**

### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Tirana Bank SHA. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2018 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

### Baza e Opinionit

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

### Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Bankës, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## **Informacione të tjera**

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i përgatitur nga Drejtimi i Bankës në përputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më sipër kur të na vihen në dispozicion dhe, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

## **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.

## Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Bankës për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Bankës, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania SHPK*

Deloitte Audit Albania SHPK

Rr. Elbasanit, Pallati poshtë Fakultetit Gjeologji - Miniera,  
Tirana, Shqipëri

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Enida Cara  
Partner Angazhim  
Auditues ligjor



19 qershor 2019  
Tiranë, Shqipëri

**Tirana Bank SHA**

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

(Të gjitha shumatat janë në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga interesi	7	1,737,847	1,884,387
Shpenzime interesi	8	(194,939)	(198,854)
<b>Të ardhura neto nga interesi</b>		<b>1,542,907</b>	<b>1,685,533</b>
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	9	417,101	423,747
Shpenzime për tarifa dhe komisione	9	(21,211)	(20,227)
<b>Të ardhura neto nga tarifa dhe komisione</b>		<b>395,890</b>	<b>403,521</b>
Humbje të pritshme nga huatë dhe paradhëniet për klientët	14	(528,404)	(130,578)
Humbje të pritshme për zhvlerësimin e huave dhe paradhënieve ndaj bankave, instrumenteve financiare dhe aktiveve jashtë bilancit	14	(48,669)	-
<b>Humbje neto nga zhvlerësimi i aktiveve financiare</b>		<b>(577,073)</b>	<b>(130,578)</b>
Humbje nga kursi i këmbimit		(1,061,059)	(254,313)
Të ardhura të tjera operative		44,535	190,675
Shpenzime personeli	10	(654,789)	(632,536)
Shpenzime të tjera operative	11	(940,954)	(939,964)
Humbje e përcaktuar nga rivlerësimi i aktiveve të investuara	16	(42,958)	(7,600)
Provizjione për zhvlerësimin e aktiveve të riposeduara	16	(246,113)	(126,437)
Shpenzime të tjera për provizjione		107,829	60,991
Zhvlerësimi dhe amortizimi	17,18	(195,451)	(185,621)
<b>Totali shpenzimeve operative</b>		<b>(2,988,960)</b>	<b>(1,879,604)</b>
<b>(Humbje)/ fitimi para tatimit</b>		<b>(1,627,236)</b>	<b>78,872</b>
Shpenzim Tatimi i shtyre	12	(4,233)	(9,493)
<b>(Humbje)/ fitimi neto për vitin</b>		<b>(1,631,469)</b>	<b>69,379</b>

**Të ardhura të tjera/(shpenzime), neto nga tatimi:**

**Zëra që mund të riklasifikohen më pas në fitim humbje:**

-Fitimi/(humbje) neto nga ndryshimi i vlerës së drejtë në aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

15 41,467 (117,979)

- Tatimi i shtyrë në lidhje me (humbjen)/fitimin nga ndryshimi i vlerës së drejtë i regjistruar direkt në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse

12 (6,220) 17,697

**Të ardhura të tjera/(humbje) gjithëpërfshirëse për vitin**

**35,247 (100,282)**

**Totali i shpenzimeve gjithëpërfshirëse për vitin**

**(1,596,222) (30,903)**

Shënimet shoqëruese në faqet 10 deri në 96 janë pjesë përzierëse e katyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi më 19 qershor 2019 dhe nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa  
Drejtör i Përgjithshëm Ekzekutiv



Edi Zeri  
Drejtör i Departamentit të Financës

**Tirana Bank SHA****Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>AKTIVE</b>			
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	13	7,120,132	6,914,728
Hua dhe paradhënie për bankat	13	17,447,073	26,544,252
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	14	20,845,099	24,037,231
Aktivitet financiar me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse ("VDPPAP")	15	23,857,367	15,343,098
Tatim fitimi i parapaguar, neto	12	94,073	26,182
Aktive afatgjata materiale të investuara	16	74,506	117,464
Aktive të riposeduara	16	2,403,649	2,921,930
Aktive afatgjata jomateriale	17	207,819	242,035
Aktive afatgjata materiale	18	529,206	498,064
Aktive tatimore të shtyra	12	22,551	33,005
Aktive të tjera	19	363,379	715,969
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>72,964,854</b>	<b>77,393,958</b>
<b>DETYRIME DHE KAPITALI</b>			
Detyrime ndaj bankave	20	2,617,270	1,252,282
Detyrime ndaj klientëve	21	57,164,880	60,957,146
Detyrime të tjera	22	399,806	617,209
Provizjone	23	131,125	62,886
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>60,313,081</b>	<b>62,889,523</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i paguar	24	14,754,741	14,754,741
Primi i aksioneve	24	1,735,494	1,735,494
Rezerva të tjera	25	1,858,716	1,700,011
Humbja e akumuluar		(5,697,178)	(3,685,811)
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>12,651,773</b>	<b>14,504,435</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE I KAPITALIT</b>		<b>72,964,854</b>	<b>77,393,958</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 10 deri në 96 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi më 19 qershor 2019 dhe nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa  
Drejtore i Përgjithshem Ekzekutiv



Tedi Zeri  
Drejtore i Departamentit të Financës




**Tirana Bank SHA****Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mije Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

	<b>Kapitali i paguar</b>	<b>Primi i aksioneve</b>	<b>Rezerva të tjera</b>	<b>Humbja e akumuluar</b>	<b>Totali i kapitalit</b>
<b>Më 1 janar 2017</b>	<b>14,754,741</b>	<b>1,735,494</b>	<b>1,800,293</b>	<b>(3,755,190)</b>	<b>14,535,338</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	69,379	69,379
Ndryshimi në Rezerva të tjera	-	-	(100,282)	-	(100,282)
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>14,754,741</b>	<b>1,735,494</b>	<b>1,700,011</b>	<b>(3,685,811)</b>	<b>14,504,435</b>
<b>Më 1 janar 2018</b>	<b>14,754,741</b>	<b>1,735,494</b>	<b>1,700,011</b>	<b>(3,685,811)</b>	<b>14,504,435</b>
Ndryshime nga impakti fillestar i SNRF 9	-	-	59,172	(379,898)	(320,726)
Humbja e vitit	-	-	-	(1,631,469)	(1,631,469)
Ndryshime në Rezervën për aktive financiare të mbajtura me VDPPAP nga aplikimi i SNRF 9	-	-	74,194	-	74,194
Ndryshime në Rezerva të tjera	-	-	25,339	-	25,339
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>14,754,741</b>	<b>1,735,494</b>	<b>1,858,716</b>	<b>(5,697,178)</b>	<b>12,651,773</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 10 deri në 96 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi më 19 qershor 2019 dhe nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa  
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Tedi Zeri  
Drejtor i Departamentit të Financës





**Tirana Bank SHA**
**Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**
*(Të gjitha shumatat janë në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)*

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
<b>FLUKSE MONETARE NGA</b>		
<b>VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT</b>		
(Humbje)/ fitim para tatimit	(1,627,236)	78,872
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësim dhe amortizim	18, 19 195,451	185,621
Ndryshime në provigjionin e huave	14 528,404	130,578
Ndryshime neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare	289,070	118,836
Të ardhurat neto nga interesi	(1,542,907)	(1,685,533)
Zëra të tjerë jomonetarë	42,506	(214,539)
	<b>(2,114,712)</b>	<b>(1,386,165)</b>
Rënie në rezervën e detyrueshme me Bankën Qendrore	214,266	361,227
Rënie në hua dhe paradhënie për klientët	2,378,127	1,030,410
Rënie në aktive të tjera	352,591	160,322
Rritje/(rënie) në detyrime ndaj bankave	1,364,989	(1,033,881)
Rënie në detyrime ndaj klientëve	(3,782,137)	(2,597,005)
Rënie /(rritje) në aktive të riposeduara	272,168	(301,384)
(Rënie) /rritje në detyrime të tjera	(217,404)	242,640
(Rritje)/rënie në tatim fitimin e parapaguar	(67,891)	25,096
Interes i arkëtuar	1,802,157	1,959,818
Interes i paguar	(205,068)	(230,103)
<b>Flukset e përdorura nga aktivitetet operative</b>	<b>(2,914)</b>	<b>(1,769,025)</b>
<b>FLUKSE MONETARE NGA</b>		
<b>AKTIVITETET INVESTUESE</b>		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	19 (138,514)	(57,307)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	18 (53,881)	(29,631)
Blerje e aktiveve financiare me VDPPAP	15 (16,277,514)	(7,499,004)
Hyrje nga maturimi i aktiveve financiare me VDPPAP	15 7,795,313	13,638,858
<b>Flukset e përdorura nga aktivitetet investuese</b>	<b>(8,674,596)</b>	<b>6,052,916</b>
(Rënie)/ rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	(8,677,510)	4,283,891
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre më 1 janar	28,236,955	23,953,064
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor</b>	<b>19,559,445</b>	<b>28,236,955</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 10 deri në 96 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi më 19 qershor 2019 dhe nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa  
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



Tedi Zeri  
Drejtor i Departamentit të Financës

## Tirana Bank SHA

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

#### 1 Informacion mbi Bankën

Tirana Bank SHA (“Banka”), u themelua në 1996 për të operuar në të gjitha fushat e aktivitetit bankar me pakicë në Shqipëri. Bazuar në nenin 4 të Statutit të Bankës, objektivi i Bankës është të veprojë, në favor të saj apo të palëve të treta, çfarëdo dhe çdo operacion të pranuar apo të deleguar Bankës sipas legjislacionit përkatës. Aktiviteti kryesor i Bankës konsiston në operacione bankare dhe financiare, bazuar në një licensë të plotë bankare të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Licensa është lëshuar në përputhje me Ligjin nr. 8365, “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”, datë 2 korrik 1998, i cili është zëvendësuar nga Ligji nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008, “Për sipërmarrësit dhe kompanitë tregtare”, ndryshuar, si edhe ligje të tjera.

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, struktura e aksionarëve të Tirana Bank SHA është si më poshtë:

Aksionari	Aksione	Në%
Piraeus Bank S.A. Greqi	496,098	98.83%
Z. Tzivelis Ioanis	5,877	1.17%
<b>Totali</b>	<b>501,975</b>	<b>100%</b>

Më 17 gusht 2018, Piraeus Bank S.A, e cila zotëron 98.83% të aksioneve të Bankës, njoftoi që kishte arritur një marrëveshje në datë 3 gusht 2018 me Balfin Group dhe Komercijalna Banka AD Skopje, për shitjen e këtyre aksioneve. Transaksioni i shitjes u aprovua në 19 janar 2019 nga Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Shqipërisë, në 6 shkurt 2019 nga Banka e Shqipërisë dhe në 28 shkurt 2019 nga Fondi Helen për Stabilitetin Financiar. Transaksioni i shitjes u finalizua në 28 shkurt 2018 (shih shënimi 30.2).

Më 31 dhjetor 2018 Banka ka 37 degë (2017: 39) në Republikën e Shqipërisë dhe nuk kryen aktivitet jashtë saj. Adresa e regjistruar e Bankës është Rruga Ibrahim Rugova, Tiranë, Shqipëri.

Më 31 dhjetor 2018 Banka ka 430 punonjës (2017:439 punonjës).

Më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, Komiteti Ekzekutiv i Bankës përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Dritan Mustafa	Drejtor Ekzekutiv
Konstantinos Tsigaras	Drejtor Finance
Eralda Tafaj	Drejtor Operacionesh
Elona Gjipali	Kryetar i Divizionit të Rikuperimit
Manjola Capo	Kryetar i Divizionit të Kredive
Eranda Shehu	Drejtor i Kredive Tregtare

Pas shitjes së Bankës më 28 shkurt 2018, siç është përmendur dhe më lart, Komiteti Ekzekutiv është si më poshtë:

Dritan Mustafa	Drejtor Ekzekutiv
Elvira Kapoli	Drejtor Finance
Eralda Tafaj	Drejtor Operacionesh
Elona Gjipali	Kryetar i Divizionit të Rikuperimit
Manjola Capo	Kryetar i Divizionit të Kredive
Lila Canaj	Drejtor i Kredive Tregtare
Glenda Kurti	Kryetar i Divizionit të Korporatave

#### **Aktiviteti kryesor**

Aktiviteti kryesor i biznesit të Bankës është veprimtaria bankare tregtare dhe individuale në Republikën e Shqipërisë. Banka kryen veprimtarinë e saj në sajë të një licence të plotë të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë (Banka e Shqipërisë ose BSH) që prej vitit 1996.

## **2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha vitet e paraqitur, nëse nuk shprehet ndryshe.

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare të Tirana Bank SHA janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Politikat e kontabilitetit të miratuara janë të qëndrueshme me ato të vitit të mëparshëm financiar.

### **2.2 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse ("VDPPAP"), që maten me vlerë të drejte. Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar dhe janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt (LEK '000), nëse nuk shprehet ndryshe.

#### **a) Pozicioni i Bankës**

Në kushtet aktuale, qëllimi kryesor i Bankës ka qenë likuiditeti dhe mjaftueshmëria e kapitalit. Ashtu siç përmendet në Shënimin 24, burimi kryesor i fondeve të Bankës përbëhet nga depozitat e mbledhura brenda vendit nga korporatat dhe individët.

Rrjedhimisht, parimi i vijimësisë është aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare. Drejtimi i ka përgatitur këto pasqyra financiare mbi parimin e vijimësisë, i cili supozon se Banka do të vazhdojë të operojë në të ardhmen e parashikueshme. Për të vlerësuar arsyetueshmërinë e këtij supozimi, Drejtimi rishikon parashikimet e flukseve hyrëse të mjeteve monetare të ardhshme dhe mbështetjen e dhënë nga aksionarët.

Në strategjinë, vizionin dhe përkushtimin e aksionarëve të rinj ndaj Bankës, citohet një mbështetje e përvokueshme për rritjen e Bankës në një të ardhme të parashikueshme.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës (siç parashikohet nga Banka e Shqipërisë) më 31 dhjetor 2018 është 29.64 % (2017: 21.25%).

Banka është në përputhje me kërkesat rregullatore mbi minimumin e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit (shih shënimin 30.1)

Politikat kryesore kontabël të përdorura në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)****2.2 Bazat e përgatitjes (vazhdim)****b) Përkthimi i transaksioneve në monedhë të huaj**

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar, që është monedha funksionale dhe e paraqitjes së Bankës.

***Transaksionet dhe tepricat***

Transaksionet në monedha të huaja përkthehen në monedhën përkatëse funksionale të operacionit në kursin e këmbimit në çast në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja në datën e raportimit janë ri-konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në çast në atë datë. Fitimi ose humbja në valutë në zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe koston e amortizuar në monedhë të huaj të përkthyer me kursin e këmbimit në çast në fund të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedhë të huaj, të cilat janë të shprehura me kosto historike, janë konvertuar në kursin mbizotërues të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja të cilat maten me vlerën e drejtë, rikthehen në monedhën funksionale në kursin e këmbimit të çastit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë.

Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen në përgjithësi në fitim ose humbje, përveç diferencave në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi i instrumentave të kapitalit të disponueshëm për shitje, të cilat njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Normat e aplikueshme të këmbimit (lekë në njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 ishin si më poshtë:

	<b>2018</b>	<b>2017</b>
USD	107.82	111.10
EUR	123.42	132.95

**2.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme*****Data e njohjes***

Blerjet apo shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë dhënien e aktiveve brenda afatit kohor të përcaktuar në përgjithësi nga rregulloret apo konventa në treg, njihen në datën e tregtimit, domethënë në datën në të cilën Banka angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

**Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël**

Banka ka zbatuar për herë të parë SNRF 9 *Instrumentet Financiarë* nga 1 janari 2018. Ai zëvendëson SNK 39 *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*. Ky shënim shpjegon ndikimin e adoptimit të SNRF 9 në pasqyrat financiare të Bankës, që rezultoi në ndryshime në politikat kontabël (ii-iii) dhe në rregullimet e shumave të njohura në pasqyrat financiare.

**SNRF 9 Instrumentet Financiare - Politikat e kontabilitetit të zbatuara nga 1 Janari 2018****i SNRF 9 - Ndikimi i adoptimit**

Siç lejohet nga Standardi, Banka zgjodhi të mos riparaqesë shumat krahasuese. Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve financiare dhe pasiveve financiare që rrjedhin nga adoptimi i SNRF 9 janë njohur në humbjen e akumuluar më 1 janar 2018. Përcaktimi i modelit të biznesit brenda të cilit është mbajtur një aktiv financiar është bërë në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**1.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)**

**ii SNRF 9 - Klasifikimi dhe matja**

SNRF 9 përmban një metodë të re klasifikimi dhe matjeje për aktivet financiare që pasqyron modelin e biznesit, në të cilin menaxhohen aktivet dhe karakteristikat e tyre të fluksit të mjeteve monetare.

SNRF 9 përfshin tre kategori kryesore klasifikimi për aktivet financiare: të matura me koston e amortizuar, VDPPAP (Vlera e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse) dhe VDPFH (Vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes). Ajo eliminon kategoritë ekzistuese të SNK 39 të mbajtura deri në maturim, hua dhe llogari të arkëtueshme dhe të disponueshme për shitje.

Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- ai është mbajtur në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të tij krijojnë në datat e specifikuar flukse të mjeteve monetare të cilat janë Vetëm Pagesa të Principalit dhe Interesit (“VPPI”) për shumën e principalit të papaguar.

Një aktiv financiar matet në VDPPAP vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- ai është mbajtur në kuadër të një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si duke mbledhur flukset monetare kontraktuale, ashtu dhe shitjen e aktiveve financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të tij krijojnë në datat e specifikuar flukse të mjeteve monetare që janë Vetëm Pagesa të Principalit dhe Interesit për shumën e principalit të papaguar.

Të gjitha aktivet financiare që nuk klasifikohen si të matura me koston e amortizuar ose VDPPAP siç përshkruhen më lart, maten në VDPFH. Përveç kësaj, në njohjen fillestare, Banka mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar që plotëson kërkesat e tjera që duhet të maten me koston e amortizuar ose në VDPPAP si në VDPFH nëse kjo e eliminimin ose zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje kontabël që do të lindte ndryshe.

Një aktiv financiar klasifikohet në një nga këto kategori në njohjen fillestare.

Sipas SNRF 9, derivatet e përfshirë në kontratat ku bartësi është një aktiv financiar në fushën e SNRF 9 nuk janë të ndarë. Në vend të kësaj, vlerësohet për klasifikim instrumenti financiar hibrid si një i tërë.

***Vlerësimi i modelit të biznesit***

Banka ka finalizuar modelin e saj të biznesit, si dhe testimin e VPPI dhe ka arritur në përfundimin si më poshtë:

➤ **Obligacione qeveritare dhe portofoli i bonove të thesarit**

Për **produktet e thesarit** të Bankës (obligacionet dhe bonot e thesarit), modeli i biznesit i identifikuar është “**Mbajtja për mbledhje e flukseve monetare dhe shitje**” që kërkon matjen me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse (“VDPPAP”) nëse edhe testi VPPI do të kalohet.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)**

**ii SNRF 9 - Klasifikimi dhe matja (vazhdim)**

➤ **Obligacione qeveritare dhe portofoli i bonove të thesarit**

Sipas SNRF 9 (4.1.2A), një aktiv financiar do të matet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale, ashtu dhe shitja e aktiveve financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të tij krijojnë në datat e specifikuar flukse të mjeteve monetare që janë Vetëm Pagesa të Principalit dhe Interesit për shumën e principalit të papaguar.

Tirana Bank nuk mban portofol të letrave me vlerë për qëllime tregtare, pra, me qëllim të blerjes/shitjes aktive në varësi të vlerës së drejtë të aktiveve.

➤ **Hua dhe paradhënie për klientët**

Për **portofolin e huave dhe paradhënieve ndaj klientëve**, modeli i biznesit i identifikuar është modeli i biznesit **“Mbajtja për mbledhje e flukseve monetare”** dhe si rrjedhojë, kreditë e klasifikuara në këtë model biznesi do të maten me koston e amortizuar nëse edhe testi i VPPI do të kalojë. Çdo hua që nuk do të kalojë testin VPPI do të matet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Sipas SNRF 9 (4.1.2), një aktiv financiar duhet të matet me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të tij krijojnë në datat e specifikuar flukse të mjeteve monetare që janë Vetëm Pagesa të Principalit dhe Interesit për shumën e principalit të papaguar.

Modeli i biznesit të Bankës është të krijojë hua dhe të mbledhë flukset e tyre kontraktuale monetare. Çdo shitje e aktiveve financiare në këtë model biznesi kryhet për shkak të përkeqësimit të kredive dhe për zvogëlimin e ekspozimeve dhe huave jo-performuese dhe në asnjë rast nuk pasqyron qëllimin fillestar të aktivitetit kreditues.

*Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit*

Për qëllimet e këtij vlerësimi, “principalit” përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. “Interesi” përcaktohet si një shpërblim për vlerën në kohë të parasë, për rrezikun kreditor që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), edhe si një marzh fitimi.

Gjatë vlerësimit nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, Banka do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)**

**ii SNRF 9 - Klasifikimi dhe matja (vazhdim)**

*Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (vazhdim)*

Gjatë kryerjes së vlerësimit, Banka merr parasysh:

- ngjarje të kushtëzuara që do të ndryshonin shumën dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare;
- karakteristikat e levës financiare;
- parapagimi dhe afatet e shtyrjes;
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Bankës për flukset e mjeteve monetare nga aktivet e specifikuar - p.sh. rregullimet e aktivitetit pa rekurs; dhe
- karakteristika që modifikojnë rëndësinë për vlerën në kohë të parasë - p.sh. rivendosjen periodike të normave të interesit.

Normat e interesit për kreditë me pakicë të kryera nga Banka janë të bazuara në Normat Fikse Standarde (NFS) të cilat janë vendosur në diskrecionin e Bankës. Në këto raste, Banka vlerëson nëse NFS është në përputhje me normat e tregut dhe i siguron Bankës kthime të mjaftueshme për të mbuluar:

- vlerën në kohë të parasë,
- rrezikun kreditor që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohe, dhe
- rreziqe të tjera bazë të huasë dhe kostot, si dhe një marzh fitimi.

Të gjitha kreditë me pakicë të Bankave përmbajnë karakteristika të parapagimit. Një tipar i parapagimit është në përputhje me kriterin e VPPI nëse shuma e parapagimit përfaqëson kryesisht shumën të papaguar të principalit dhe interesit mbi shumën e papaguar të principalit, që mund të përfshijë kompensim të arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës.

**Tirana Bank SHA****Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)****2.3 Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****Ii SNRF 9 - Klasifikimi dhe matja (vazhdim)***Vlerësimi i impaktit*

Banka ka vlerësuar se adoptimi i SNRF 9 më 1 janar 2018 do të sjellë ndryshime në matjen e saj aktuale të aktiveve financiare sipas SNK 39. Klasifikimi i aktiveve të saj financiare të mbajtura më 1 janar 2018 do të ndryshojë si më poshtë:

Tabela e ndryshimeve në klasifikimin dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare në datën e zbatimit fillestar të SNRF 9.

	SNK 39		SNRF 9	
	Kategoria e matjes	Vlera e mbetur deri më 31 dhjetor 2017	Kategoria e matjes	Vlera e mbetur prej 1 janarit 2018
<b>Aktive financiare</b>				
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	Kosto e amortizuar (Hua dhe llogaritë e arkëtueshme)	6,914,728	Kostoja e amortizuar	6,914,728
Hua dhe paradhënie për bankat, neto	Kosto e amortizuar (Hua dhe llogaritë e arkëtueshme)	26,544,252	Kostoja e amortizuar	26,516,343
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	Kosto e amortizuar (Hua dhe llogaritë e arkëtueshme)	24,037,231	Kostoja e amortizuar	23,815,940
Aktive financiare me vlerën e drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse ("VDPPAP")	VDPPAP (Aktive të vlefshme për shitje)	15,343,098	VDPPAP	15,283,926
Provigjon (garanci financiare)	Kostoja e amortizuar (Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme)	5,572,540	Kostoja e amortizuar	5,501,013



**Tirana Bank SHA****Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)****2.3 Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****ii SNRF 9 - Klasifikimi dhe matja (vazhdim)****Vlerësimi i ndikimit (vazhdim)**

Tabela e ndryshimeve në klasifikimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare, në datën e aplikimit fillestar të SNRF 9, me ndryshimet në vlerën kontabël që rrjedhin nga një ndryshim në atributin e matjes nga kalimi në SNRF 9.

	<b>SNK 39 vlera kontabël 31 dhjetor 2017</b>	<b>Riklasifikimet</b>	<b>Rimatje, SNRF 9,</b>	<b>SNRF 9 Vlera kontabël 1 janar 2018</b>
<b><i>Kosto e amortizuar</i></b>				
<b>Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore</b>				
Teprica hapëse sipas SNK 39 dhe teprica mbyllëse sipas SNRF 9	<b>6,914,728</b>	-	-	<b>6,914,728</b>
<b>Hua dhe paradhënie për bankat</b>				
Teprica hapëse sipas SNK 39	<b>26,544,252</b>	-	27,909	
Rimatje: Llogaritja e HPK		-		
Teprica mbyllëse sipas SNRF 9				<b>26,516,343</b>
<b>Hua dhe paradhënie për klientët, neto</b>				
Teprica hapëse sipas SNK 39	<b>24,037,231</b>	-	221,291	
Rimatje: Llogaritja e HPK		-		
Teprica mbyllëse sipas SNRF 9				<b>23,815,940</b>
<b>Totali i aktiveve financiare të matura me kosto të amortizuar</b>	<b>57,496,211</b>	-	246,532	<b>57,249,679</b>
<b><i>Vlera e drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse (VDPPAP)</i></b>				
<b>Letra me vlerë- Aktive financiare VDPPAP</b>				
Teprica hapëse sipas IAS 39	<b>15,343,098</b>	-	59,172	
Rimatje: Llogaritja e HPK		-		
Teprica mbyllëse sipas SNRF 9		-	-	<b>15,283,926</b>
<b>Totali i aktiveve financiare VDPPAP</b>	<b>15,343,098</b>	-	-	<b>15,283,926</b>
<b>Angazhime të huasë dhe kontrata të garancisë financiare</b>				
<b>Provizjone (garanci financiare)</b>				
Teprica hapëse sipas SNK 39	<b>5,572,540</b>	-	-	-
Rimatje: Llogaritja e HPK	-	-	71,572	-
Teprica mbyllëse sipas SNRF 9	-	-	-	<b>5,501,013</b>
<b>Totali i angazhimeve të huasë dhe kontratave të garancisë financiare</b>		-	71,572	
<b>Totali i ndikimit të SNRF 9</b>	-	-	<b>379,898</b>	-

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**iii SNRF 9 - Zhvlerësimi**

SNRF 9 zëvendëson modelin e “humbjeve të ndodhura” në SNK 39 me një model që orientohet nga e ardhmja, si modeli i “humbjes së pritshme të kredisë” (“HPK”). Kjo do të kërkojë gjykim të konsiderueshëm se si ndryshimet në faktorët ekonomikë ndikojnë mbi HPK-të, të cilat përcaktohen në bazë të probabilitetit të ponderuar.

Përveç aktiveve që maten me kosto të amortizuar, modeli i ri i zhvlerësimit zbatohet edhe për instrumentet financiare në vijim që nuk maten me VDPFH:

- aktivet financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- angazhimet e huave dhe kontratat e garancisë financiare të lëshuara (*më parë, zhvlerësimi është matur sipas SNK 37 Provigjonet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara*).

SNRF 9 kërkon të njihet një humbje e zbritshme në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore ose HPK-të e përjetshme në varësi të vlerësimit të rrezikut të mospagimit. HPK-të e përjetshme janë HPK-të që rezultojnë nga të gjitha rastet e mundshme të mospagimit gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar, ndërsa HPK-të 12-mujore janë pjesë e HPK-ve që rezultojnë nga rastet e mospagimit që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Banka njih humbjet e zbritshme në një shumë të barabartë me HPK-të e përjetshme, përveçse në rastet e mëposhtme, për të cilat shuma e njohur do të jetë HPK 12-mujore:

- instrumentet e borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët kreditor në datën e raportimit. Banka e konsideron një letër me vlerë borxhi të ketë rrezik të ulët kredie kur vlerësimi i rrezikut të saj kreditor është ekuivalent me përkufizimin e kuptimit global të “klasës së investimit”; dhe
- huatë dhe instrumentet e borxhit për të cilat rreziku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 janë komplekse dhe kërkojnë gjykime, vlerësime dhe supozime të Drejtimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme, të cilat diskutohen në detaje më poshtë:

- Llogaritja e input-eve kryesore të HPK, si Probabiliteti i Mospagimit, Humbja e ardhur nga Mospagimi dhe Ekspozimi në Mospagim;
- vlerësimi nëse rreziku kreditor së një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare; dhe
- përfshirja e informacionit për të ardhmen në matjen e HPK-ve.

**Matja e HPK-ve**

HPK-të janë një vlerësim i ponderuar me probabilitetet e humbjeve të kredive dhe do të maten si më poshtë:

- *aktivët financiarë që nuk janë të zhvlerësuar nga kreditë në datën e raportimit*: vlera aktuale e të gjitha mangësive në të holla – që do të thotë. diferenca midis flukseve të mjeteve monetare që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që Banka pret të marrë;
- *aktivët financiarë që janë të zhvlerësuar nga kreditë në datën e raportimit*: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar;

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**iii SNRF 9 - Zhvlerësimi (vazhdim)**

**Matja e HPK-ve (vazhdim)**

- *angazhimet e huasë të patërhequra*: vlera aktuale e diferencës ndërmjet flukseve të mjeteve monetare kontraktuale që i detyrohen Bankës nëse angazhimi dhe flukset e mjeteve monetare që Banka pret të marrë janë tërhequr; dhe
- *kontratat e garancisë financiare*: vlera aktuale e pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të rikuperojë.

Aktivitetet financiare që janë të zhvlerësuar nga kredia janë përcaktuar nga SNRF 9 në mënyrë të ngjashme me aktivitetet financiare që janë zhvlerësuar sipas SNK 39.

**Hyrjet (inputet) në matjen e HPK-ve**

Hyrjet (inputet) kryesore në matjen e HPK-ve kanë të ngjarë të jenë struktura afatgjata të variabla në vijim: Probabiliteti i Mospagimit, Humbja e ardhur nga Mospagimi; dhe Ekspozimi në Mospagim.

Këto parametra rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara nga brenda dhe të dhëna të tjera historike që përdorin modelet rregullatore. Ato janë të përshtatura për të pasqyruar informacionin e ardhshëm siç përshkruhet më poshtë.

Nivelet e rrezikut kreditor do të jenë një kontribut primar në përcaktimin e strukturës afatgjatë të Probabilitetit të Mospagimit për ekspozimet. Banka do të përdorë modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të Probabilitetit të Mospagimit së mbetur të ekspozimeve dhe se si këto pritet të ndryshojnë si pasojë e kalimit të kohës.

Kjo analizë do të përfshijë identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve midis ndryshimeve në normat e mospagimit dhe ndryshimeve në faktorët kryesorë makroekonomikë, si dhe analizën e thellë të ndikimit të disa faktorëve të tjerë (p.sh. përvoja e qëndrueshmërisë) në rrezikun e mospagimit. Për shumicën e ekspozimeve, treguesit kryesorë makroekonomikë ka të ngjarë të përfshijnë rritjen e PBB-së, normat e interesit dhe papunësinë. Qasja e Bankës për përfshirjen e informacioneve të ardhshme në këtë vlerësim është diskutuar më poshtë.

Humbja e Ardhur nga Mospagimi është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një mospagim. Banka do të vlerësojë parametrat e Humbjes së Ardhur nga Mospagimi bazuar në historinë e normave të rimëkëmbjes së kërkesave ndaj palëve të papaguara. Modelet Humbjes së Ardhur nga Mospagimi do të marrin në konsideratë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës dhe kostot e rimëkëmbjes të çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e aktivitetit financiar. Për kreditë e siguruar nga prona me pakicë, raportet e cilësisë së kredisë (LTV) ka gjasa të jenë një parametër kyç në përcaktimin e LGD.

Ekspozimi në Mospagim përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një mospagimi. Banka do të nxjerr Ekspozimi në Mospagim nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës, përfshirë amortizimin dhe parapagimet. Ekspozimi në Mospagim i një aktiviteti financiar do të jetë vlera kontabël bruto në mospagim. Për angazhimet e huadhënies dhe garancitë financiare, Ekspozimi në Mospagim do të marrë parasysh shumën e tërhequr, si dhe shumat potenciale të ardhshme që mund të nxirren ose paguhen sipas kontratës, të cilat do të vlerësohen bazuar në vërtetimet historike dhe parashikimet e ardhshme.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**iii SNRF 9 - Zhvlerësimi (vazhdim)**

**Hyrjet (inputet) në matjen e HPK-ve (vazhdim)**

Banka do të matë HPK-të duke marrë në konsideratë rrezikun e mospagimit për periudhën maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjerimit të huamarrësit) mbi të cilat ai është i ekspozuar ndaj rrezikut kreditor, edhe pse për qëllime të administrimit të rrezikut, Banka merr parasysh një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie ose të ndërpresë një angazhim ose garanci kredie.

Për overdraftet me pakicë dhe objektet e kartës së kreditit dhe disa struktura rrotulluese të korporatave që përfshijnë si një hua dhe një përbërës të angazhimit të patërhequr, Banka mund të matë HPK-të për një periudhë më të gjatë se periudha maksimale kontraktuale, nëse aftësia kontraktuale e Bankës për të kërkuar ripagimin dhe anulimin e angazhimit të patërhequr nuk kufizon ekspozimin e Bankës ndaj humbjeve të kredisë në periudhën e njoftimit kontraktual. Këto lehtësira nuk kanë një afat të caktuar ose strukturë të ripagimit dhe menaxhohen në baza kolektive. Banka mund t'i anulojë ato me efekt të menjëhershëm, por kjo e drejtë kontraktuale nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm, por vetëm kur Banka vihet në dijeni për një rritje të rrezikut kreditor. Megjithatë, kjo periudhë do të vlerësohet duke marrë parasysh veprimet e menaxhimit të riskut kreditor që Banka pret të ndërmarrë dhe që shërbejnë për të zbutur HPK-të. Këto përfshijnë një ulje të limiteve dhe anulimin e lehtësirave që Banka ofron.

Kur modelimi i një parametri kryhet në baza kolektive, instrumentet financiare do të grupohen në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut që përfshijnë:

- llojin e instrumentit; dhe
- klasifikimin e rrezikut kreditor.

Grupimet do t'i nënshtrohen rishikimit të rregullt për të siguruar që ekspozimet brenda një grupi të caktuar të mbeten në mënyrë të përshtatshme homogjene.

Për investimet në letrat me vlerë të borxhit, në lidhje me të cilat Banka ka të dhëna të kufizuara historike, informacionet e jashtme referuese të publikuara nga agjencitë e njohura të vlerësimit të jashtëm të kredive si Moody's do të përdoren për të plotësuar të dhënat në dispozicion brenda vendit.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**iii SNRF 9 - Zhvlerësimi (vazhdim)**

**Matja e HPK-ve (vazhdim)**

**Përkufizimi i mospagimit**

Sipas SNRF 9, Banka do të konsiderojë një aktiv financiar të jetë i papaguar kur:

- huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të kredisë në Bankë në tërësi, pa pasur nevojë nga ana e Bankës për veprime të tilla si realizimi i letrës me vlerë (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë pa i paguar një detyrim material kredie Bankës.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullative për huatë e klasifikuara si nën standard, të dyshimta ose të humbura.

Identifikimi i karakteristikave të mëposhtme rezulton në mospagim.

- a) Ditët e kaluara të pagesës. Ekspozimet më shumë se 90 ditë me vonesë në datën e raportimit (duke përdorur efektin e tërheqjes prej 20% - në nivelin e debitorit).
- b) Vështirësia për të paguar
- c) Aktivi i zhvlerësuar i kredisë siç përcaktohet në kërkesat e SNRF 9
- d) Ekspozime jo performuese të modifikuara
- e) Ekspozime performuese të modifikuara gjatë periudhës së provës (24 muaj pas periudhës së kurimit) për të cilat masat e modifikime janë zgjatur ose kanë më shumë se 90 ditë vonesë.

Inputet e përdorura për të vlerësuar në se një instrument financiar kategorizohet në mospagim, si dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana.

**Nivelet e rrezikut kreditor**

Banka cakton çdo ekspozim nga biznesi në një nivel rreziku kreditor bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Menaxhimit të Rrezikut kreditor duke përdorur faktorë cilësorë dhe sasiorë që janë tregues të rrezikut të mospagimit. Krahas klasave të rrezikut të prezantuara për qëllime rregullatore, Banka identifikon dhe monitoron veçmas huatë standarde të paguara me vonesë, nga huatë standarde jo të paguara me vonesë.

Çdo ekspozim i biznesit ndahet në një klasë të riskut kreditor në njohjen fillestare bazuar në informacionin në dispozicion për huamarrësin. Ekspozimet i nënshtrohen monitorimit të vazhdueshëm, të cilat mund të rezultojnë në një ekspozim të zhvendosur në një klasë tjetër të rrezikut kreditor.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**iii SNRF 9 - Zhvlerësimi (vazhdim)**

**Përkufizimi i mospagimit (vazhdim)**

***Përcaktimi nëse rreziku kreditor është rritur ndjeshëm***

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse rreziku kreditor (për shembull rreziku i mospagimit) të një instrumenti financiar është rritur dukshëm që nga njohja fillestare, Banka do të marrë parasysh informacione të arsyeshme dhe të mbështetura që janë relevante dhe të disponueshme, pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, duke përfshirë informacionin cilësor dhe sasior dhe analizën bazuar në përvojën historike të Bankës, vlerësimin e ekspertëve të kredive dhe informacionin e ardhshëm.

Banka konsideron si kriteret sasiorë ashtu edhe cilësorë në mënyrë që të vlerësojë nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e rrezikut kreditor.

Elementi sasior llogaritet në bazë të ndryshimit në probabilitetin të mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë duke krahasuar:

- Probabilitetin e mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë të mbetur në datën e raportimit; me
- Probabilitetin e mospagimit për të gjithë jetëgjatësinë që u vlerësua në bazë të fakteve dhe rrethanave në kohën e njohjes fillestare të ekspozimit

Banka përcakton kriteret për rritjen sasiorë relative në probabilitetin e mospagimit, të cilat tregojnë një rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor.

Banka ka vendosur tre lloje treguesish: a) primar, b) sekondar dhe c) ndalesa për të demonstruar prioritetin e treguesve të përdorur për të vlerësuar nëse ka ndodhur rritje e ndjeshme e rrezikut kreditor. Pavarësisht prioritetit të tyre, të gjithë kriteret kanë të njëjtën peshë në procesin e vlerësimit për rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor.

Treguesit primarë ose sekondar mund të ndryshojnë për secilin portofol, ndërsa treguesi i ndaluar është i pranishëm në kushtet e mëposhtme:

- Instrumentet të cilat kanë kaluar më shumë se 30 ditë

Të gjitha kreditë që shfaqin rritje të konsiderueshme në riskun kreditor klasifikohen në Nivelin 2.

Banka do të monitorojë efektivitetin e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme të riskut kreditor, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se:

- kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme në riskun kreditor para se një ekspozim të jetë në mospagim;
- koha mesatare midis identifikimit të një rritjeje të konsiderueshme të riskut kreditor dhe mospagimit duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet në përgjithësi nuk transferohen drejtpërdrejt nga matjet e HPK-ve 12-mujore të kredia e zhvlerësuar.

**Mjetet financiare të modifikuara**

Kushtet kontraktuale të një huaje mund të ndryshohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientëve dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim aktual ose potencial të kredisë të klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilës janë modifikuar, mund të çregjistrohet dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë.

Sipas SNRF 9, kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, Banka shqyrton nëse rreziku kreditor së aktivitetit është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësorë që ndikojnë në rrezikun e mospagimit.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.3 Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**iii. SNRF 9 - Zhvlerësimi (vazhdim)**

**Nivelet e rrezikut kreditor (vazhdim)**

***Mjete financiare të modifikuara (vazhdim)***

Banka rinegocion huatë për klientët në vështirësi financiare (të referuara si “aktivitete modifikuese”) për të rritur mundësitë e grumbullimit dhe për të minimizuar rrezikun e mospagimit. Sipas politikës së modifikimeve të Bankës, modifikimi huasë jepet në baza selektive nëse debitori momentalisht është në mospagim të borxhit të tij ose nëse ekziston një rrezik i lartë i mospagimit, ka dëshmi se debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kushteve të kontratës fillestare dhe debitori pritet të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e rishikuara.

Kushtet e rishikuara zakonisht përfshijnë zgjatjen e maturitetit, ndryshimin e kohës së pagesave të interesit dhe ndryshimin e kushteve të marrëveshjeve të huasë. Të dyja kreditë e tregtueshme dhe të biznesit janë subjekt i politikës së qëndrueshmërisë.

Në përgjithësi, modifikimi është një tregues cilësor i vonesës dhe zhvlerësimit të kredisë dhe pritshmëritë ndaj modifikimeve janë relevante për të vlerësuar nëse ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor. Në vijim të modifikimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë të pagesave të vazhdueshme gjatë *njëzetekatër muajve* përpara se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore.

**Informacionet e ardhshme**

Sipas SNRF 9, Banka do të inkorporojë informacione të ardhshme në të dyja vlerësimet e saj nëse rreziku kreditor i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe matjen e HPK-ve. Banka do të formulojë një skenar bazë për drejtimin e ardhshëm të variablave përkatës ekonomike dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikimit bazuar në këshillat e Komitetit të Rrezikut të Bankës dhe ekspertëve ekonomikë dhe shqyrtimin e një sërë informacionesh të jashtme aktuale dhe parashikuese.

Ky proces përfshin zhvillimin e dy ose më shumë skenarëve ekonomikë shtesë duke marrë parasysh probabilitetet relative të secilit rezultat. Informacioni i jashtëm mund të përfshijë të dhëna ekonomike dhe parashikime të publikuara nga organet qeveritare dhe autoritetet monetare në vendet ku vepron Banka, organizata ndërkombëtare si Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe sektori privat i përzgjedhur dhe parashikuesit akademikë.

Rasti bazë do të paraqesë një rezultat më të mundshëm dhe do të përafrohet me informacionin e përdorur nga Banka për qëllime të tjera, siç është planifikimi strategjik dhe buxhetimi. Skenarët e tjerë do të përfaqësojnë rezultate më optimiste dhe më pesimiste. Banka gjithashtu do të kryejë në mënyrë periodike testimin e stresit të goditjeve më ekstreme për të kalibruar përcaktimin e këtyre skenarëve të tjerë përfaqësues.

Banka ka identifikuar dhe dokumentuar nxitësit kryesorë të rrezikut kreditor dhe humbjet e kredisë për secilin portofol të instrumenteve financiare dhe duke përdorur një analizë të të dhënave historike, ka vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet variablave makroekonomike dhe rrezikut kreditor dhe humbjeve të kredisë. Këto drejtues kryesorë përfshijnë Indeksi i Çmimeve të Konsumit (“IÇK”), normat e papunësisë dhe parashikimet e indeksit të Produkteve të Brendshme Bruto (“PBB”). Marrëdhëniet e parashikuara midis treguesve kryesorë dhe normave të mospagimit dhe humbjeve në portofole të ndryshme të aktiveve financiare janë zhvilluar bazuar në analizimin e të dhënave historike gjatë 5 viteve të fundit.

## Tirana Bank SHA

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

## 2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

### 2.3 Ndryshime në politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### iii. SNRF 9 - Zhvlerësimi (vazhdim)

##### Vlerësimi i ndikimit

Ndikimi më i rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës nga zbatimi i SNRF 9 rezulton nga kërkesat e reja të zhvlerësimit. Humbjet nga zhvlerësimi janë rritur dhe mund të bëhen më të paqëndrueshme për instrumentet financiare në kuadër të modelit të SNRF 9 të zhvlerësimit, si më poshtë.

Tabela më poshtë paraqet rakordimin e zhvlerësimit përfundimtar në përputhje me SNK 39 dhe provigjonet në përputhje me SNK 37 me humbjen e lejueshme të pritshme përcaktuar në përputhje me SNRF 9.

Kategoria e matjes	Provigjonimi sipas SNK 39/SNK 37	Riklasifikimi	Rimatje	Provigjonimi sipas SNRF 9
<b>Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme (SNK 39) / Aktivët financiarë me koston e amortizuar (SNRF 9)</b>				
Mjete monetare dhe llogaritë me Bankën Qendrore	-	-	-	-
Hua dhe paradhënie për bankat	-	-	27,909	27,909
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	3,334,554	-	221,291	3,555,845
<b>Totali</b>	<b>3,334,554</b>		<b>249,200</b>	<b>3,583,754</b>
<b>Instrumentet financiare të gatshme për shitje (SNK 39) / Aktivët financiarë në VDPPAP (SNRF 9)</b>				
Investimet në letra me vlerë	-	-	59,172	59,172
<b>Kontratat e huasë dhe kontratat e garancisë financiare</b>				
Huatë dhe paradhëniet për klientët (angazhimet e huasë)	-	-	-	-
Provigjonet (angazhimet e huasë)	-	-	-	-
Provigjonet (garancitë financiare)	-	-	71,527	71,527
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>130,698</b>	<b>130,698</b>
<b>Ndikimi total i SNRF 9</b>			<b>379,898</b>	

#### Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme

##### e) Kompensimi i instrumentave financiare

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ekziston një e drejtë ligjore për të netuar shumat e njohura dhe ekziston synimi për shlyerje në baza kompensimi, ose për të realizuar aktivin apo shlyer detyrimin njëkohësisht.

##### f) Çregjistrimi

Aktivët financiarë çregjistrohen kur përfundojnë së ekzistuari të drejtat kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi, ose kur aktivi dhe të gjithë rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së tij janë transferuar (që domethënë, nëse të gjitha rreziqet dhe shpërblimet nuk janë transferuar tërësisht, banka teston kontrollin për t'u siguruar që përfshirja e vazhdueshme në bazë të të drejtave të mbetura nuk parandalon çregjistrimin). Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato ripaguhen ose anulohen.



## **2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.4 Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellat të riblerjes**

Letrat me vlerë të shitura përmes marrëveshjeve për t'i riblerë në një datë të ardhshme të specifikuar ("REPO") nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Arkëtimet përkatëse, duke përfshirë interesin e përlllogaritur, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si detyrime ndaj bankave, duke pasqyruar thelbin ekonomik të kredisë bankare. Diferenca midis çmimit të shitjes dhe të riblerjes trajtohet si shpenzim interesi dhe maturohet përgjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Ndërkohë letrat me vlerë të blera përmes marrëveshjeve për rishitje në një datë të ardhshme të specifikuar, marrëveshjet e anasjella të riblerjes ('Reverse REPO'), regjistrohen si detyrime ndaj bankave të tjera ose hua dhe paradhënie për klientë, sipas rastit. Pagesat përkatëse të kryera, duke përfshirë interesin e përlllogaritur, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si detyrime ndaj bankave. Diferenca midis çmimit të blerjes dhe atij të rishitjes trajtohet si e ardhur nga interesi dhe maturohet përgjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

### **2.5 Përcaktimi i vlerës së drejtë**

Për instrumentet financiare që tregtohen në tregje aktive, përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e tregut ose kuotimet e çmimit nga ndërmjetësit. Një instrument financiar konsiderohet si i kuotuar në treg aktiv nëse çmimet e kuotuar janë të gatshme dhe rregullisht të publikuara në bursë nga ndërmjetës, grupe industrish, shërbime çmimesh dhe agjenci rregullatore, dhe këto çmime përfaqësojnë transaksione të rregullta të vërteta që kryhen me vlera të drejta. Nëse kriteret e mësipërme nuk përmbushen, tregu konsiderohet si jo-aktiv. Treguesit që tregu nuk është aktiv janë kur ka hapësirë të madhe midis çmimit të ofertës dhe kërkesës, ose kur ka pak transaksione kohët e fundit, një rënie të konsiderueshme në mesataren e vëllimit të tregtimit ditor të të gjitha aksioneve në shqyrtim në vend gjatë 5 viteve të fundit, etj.

Për të gjitha ato instrumente financiare që nuk janë të listuara në treg aktiv, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur metoda të përshtatshme vlerësimi. Metoda të tilla përfshijnë teknika të llogaritjes së vlerës aktuale, krahasimin me instrumente të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime të publikuara dhe modele të tjera të përshtatshme. Metoda të vlerësimit si modelet e flukseve monetare të skontuara ose modele të bazuar në transaksione duarlibër ose konsiderata në të dhënat financiare të investuesve përdoren për matjen e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare për të cilët informacioni i jashtëm për përcaktimin e çmimit nuk është i disponueshëm.

Metodat e vlerës së drejtë analizohen në nivele hierarkike siç vijon: (i) metodat e nivelit të parë janë ato që përdorin çmime të kuotuar në tregje aktive për aktive ose detyrime identike; (ii) metoda të nivelit të dytë përbëjnë teknika vlerësimi që përdorin të gjitha të dhënat e observueshme për aktivin ose detyrimin, në mënyrë direkte (si çmimet) ose indirekte (që derivojnë nga çmimet), dhe (iii) metoda të nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e observueshme të tregut (metoda kërkon të dhëna të rëndësishme të pa observueshme).

## **2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.6 Qiraja**

Përcaktimi nëse një marrëveshje është ose përmban një qira bazohet në thelbin e marrëveshjes, e cila kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes është në varësi të përdorimit të aktivitet apo aktiveve specifike dhe marrëveshja transferon një të drejtë për të përdorur aktivin.

#### *i. Banka si qiramarrës*

Qiratë financiare, të cilat i transferojnë bankës në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e objektit të qirasë, kapitalizohen me fillimin e afatit të qirasë me vlerën e drejtë të pasurisë së marrë me qira ose, kur është më e vogël, me vlerën e drejtë të pagesave minimale të qirasë dhe përfshihen në llogarinë “Aktive afatgjata materiale”, me detyrimin përkatës ndaj qiradhënësit të përfshirë në “Detyrime të tjera”. Pagesat e qirasë ndahen midis shpenzimit financiar dhe detyrimit të qirasë për të arritur një normë konstante interesi mbi gjendjen e mbetur të detyrimit. Shpenzimet financiare regjistrohen drejtpërdrejt kundrejt të ardhurave si shpenzime interesi. Banka nuk kishte marrëveshje të rëndësishme qiraje financiare gjatë periudhës së raportimit.

Aktivet e kapitalizuara të qirasë amortizohen përgjatë kohës më të shkurtër midis jetës së dobishme të vlerësuar të aktivitet dhe afatit të qirasë, nëse nuk ka siguri të arsyeshme që banka do të marrë pronësinë e objektit në fund të afatit të qirasë. Detyrimet e pagesave të qirasë së zakonshme kontabilizohen në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë dhe njihen si shpenzime të tjera operative. Kur një qira e zakonshme përfundon para se afati i qirasë të ketë përfunduar, çdo pagesë e kërkuar nga qiradhënësi si penalitet njihet si shpenzim në periudhën kur përfundimi ka ndodhur.

#### *ii. Banka si qiradhënësi*

Kur banka është qiradhënësi në një qira, e cila në thelb nuk transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë nga banka tek qiramarrësi, totali i pagesave të qirasë njihet në fitim ose humbje të vitit (të ardhura nga qiraja – shënimi 2.7, c) në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë.

### **2.7 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet ekonomike mund të maten në mënyrë të besueshme. Kriteret specifike në vijim duhet të përmbushen që të ardhurat të njihen.

#### *a) Të ardhura dhe shpenzime nga interesi*

Të ardhurat nga interesi përfshijnë kupona të fituar nga investimet me të ardhura të pandryshueshme, zbritjen e maturuar dhe primin nga bonot e thesarit dhe të ardhura interesi nga hua dhe paradhënie. Për të gjithë instrumentet financiare të matur me kosto të amortizuar dhe instrumentet financiare të klasifikuar si të vlefshme për shitje që mbartin interes, e ardhura ose shpenzimi nga interesat regjistrohet me normën efektive të interesit, e cila është norma që barazon vlerën aktuale të pagesave ose arkëtimeve monetare të ardhshme përgjatë jetës së instrumentit financiar, ose një periudhë më të shkurtër, sipas rastit, me vlerën e mbetur neto të aktivitet ose detyrimit financiar.

Përlllogaritja merr parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, mundësitë e parapagimit) dhe përfshin çdo tarifë ose kosto rritëse që lidhet direkt me instrumentin dhe janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit, por përjashton humbjet e ardhshme të kredisë. Vlera e mbetur e aktivitet ose detyrimit financiar rregullohet nëse banka rishikon vlerësimet e saj të pagesave dhe arkëtimeve. Vlera e mbetur e rregulluar llogaritet duke u bazuar në normën efektive fillestare të interesit dhe ndryshimi në vlerën e mbetur regjistrohet si e ardhur ose shpenzim interesi. Kur vlera e regjistruar e aktivitet financiar ose e një grupi aktivesh të ngjashme financiare është reduktuar si pasojë e një humbjeje zhvlerësimi, të ardhurat nga interesi vazhdojnë të njihen duke përdorur normën efektive të interesit që përdoret kundrejt vlerës së re të mbetur.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.7 Njohja e të ardhurave (vazhdim)**

*b) Të ardhura nga tarifa dhe komisione*

Banka fiton tarifa dhe komisione nga një gamë e ndryshme shërbimesh që ajo u ofron klientëve të saj. Të ardhura nga tarifat mund të ndahen në dy kategoritë e mëposhtme:

*i. Të ardhura nga tarifat për shërbime që ofrohen përgjatë një periudhe të caktuar kohe*

Tarifat e fituara për kryerjen e shërbimeve përgjatë një periudhe kohe maturohen përgjatë asaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë të ardhura nga komisionet dhe menaxhimin e aktiveve, tarifa për mirëbesim dhe për menaxhim dhe këshillime të tjera. Tarifat për angazhimet e kredisë, për kredi që do të përdoren, dhe tarifa për kredi të tjera shtyhen (së bashku me kostot rritëse) dhe njihen si rregullim i normës efektive të interesit kundrejt kredisë.

*ii. Të ardhura nga tarifat për shërbime transaksioni*

Tarifat që rezultojnë nga negocimi ose pjesëmarrja në negocimin e transaksioneve për një palë të tretë – si marrëveshja e blerjes së aksioneve apo letrave të tjera me vlerë ose blerja apo shitja e bizneseve – njihen në përfundim të transaksionit përkatës. Tarifat ose pjesët përbërëse të tarifave që lidhen me një performancë të caktuar njihen pas përmbushjes së kriterëve përkatëse.

*b) Të ardhura nga qiraja*

Të ardhurat nga qiraja kontabilizohen në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë, dhe regjistrohen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera operative. Banka nuk kishte pasuri investimi të rëndësishme në fund të vitit dhe gjatë periudhës së raportimit.

**2.8 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë gjendjet e parasë dhe depozitat në të parë me një maturitet fillestar tre mujor ose më pak. Për pasqyrën e flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga arka, llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore dhe llogaritë në të parë me bankat e tjera dhe me maturitet fillestar tre mujor ose më pak. Rezerva e detyruar me Bankën Qendrore nuk është e disponueshme për veprimtarinë e përditshme të bankës dhe nuk përfshihet si përbërës i mjeteve monetare për pasqyrën e flukseve monetare. Mjetet monetare mbahen me kosto të amortizuar. Më shumë detaje për mjetet monetare gjenden në shënimin 13.

## **2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.9 Aktive afatgjata materiale**

Aktivitet afatgjata materiale mbahen me kosto, duke përjashtuar kostot e shërbimeve të përditshme, minus amortizimin dhe zhvlerësimin e akumuluar.

Amortizimi llogaritet duke përdorur mënyrën lineare për të zvogëluar koston e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e tyre të rikuperueshme përgjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Toka nuk amortizohet. Jetët e dobishme të vlerësuara janë si në vijim:

- Ndërtesa: deri në 20 vite
- Mobilje dhe pajisje të tjera: 5 vite
- Automjete: 5 vite
- Pajisje kompjuterike: 4 vite
- Përmirësime të ambienteve të marra me qira: më e shkurtra midis jetës së dobishme dhe afatit të qirasë

Vlera e rikuperueshme e aktivitet dhe jetët e dobishme rishikohen dhe rregullohen, nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi.

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur aktivi shitet ose kur nuk priten më përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi apo shitja e tij. Çdo fitim ose humbje nga çregjistrimi i aktivitet (llogaritur si diferencë midis arkëtimit neto nga shitja dhe vlerës së mbetur të aktivitet) njihet si të ardhura të tjera operative ose shpenzime të tjera operative në fitim ose humbje të vitit kur aktivi çregjistrohet.

### **2.10 Aktive afatgjata jomateriale**

#### *Aktive afatgjata jomateriale të blera veçmas*

Aktivitet afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të fundme që janë blerë veçmas mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimi i amortizimit njihet mbi një bazë lineare përgjatë jetës së dobishme. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese, me efektin e donjë ndryshimi në vlerësim që njihet në bazë prospektive. Aktivitet afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të pafundme që janë blerë veçmas mbahen me kosto, minus humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

#### *Aktive afatgjata jomateriale të krijuara brenda Bankës – shpenzime për kërkim dhe zhvillim*

Shpenzimet për aktivitetet kërkimore njihen si shpenzime në periudhën kur ato ndodhin.

Një aktiv afatgjatë jomaterial i krijuar brenda Bankës që rrjedh nga zhvillimi (ose nga Niveli e zhvillimit të një projekti të brendshëm) njihet nëse, dhe vetëm nëse, vërtetohen të gjitha zërat e mëposhtëm:

- fizibiliteti teknik i përfundimit të aktivitet jomaterial në mënyrë që të jetë në dispozicion për përdorim ose shitje;
- qëllimi për të përfunduar aktivitet jomaterial dhe ta përdorë ose shesë atë;
- aftësia për të përdorur ose shitur aktivitet jomaterial;
- se si aktivitet jomaterial do të gjenerojë përfitime ekonomike të mundshme në të ardhmen;
- disponueshmëria e burimeve të përshtatshme teknike, financiare dhe të tjera për të përfunduar zhvillimin dhe për të përdorur ose shitur aktivitet jomaterial; dhe
- aftësia për të matur me besueshmëri shpenzimet që i përkasin aktivitet jomaterial gjatë zhvillimit të tij.

## **2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.10 Aktive afatgjata jomateriale (vazhdim)**

Shuma e njohur fillimisht për aktivet jomateriale të krijuara brenda Bankës është shuma e shpenzimeve të ndodhura nga data kur aktivi jomaterial plotëson për herë të parë kriteret e njohjes të listuara më sipër. Kur nuk njihet asnjë aktiv jomaterial i krijuar brenda Bankës, shpenzimi i zhvillimit njihet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ndodh.

Pas njohjes fillestare, aktivet jomateriale të krijuara brenda Bankës raportohen me kosto historike minus amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë, në të njëjtën bazë si aktive jomateriale që janë të blera veçmas. Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë programet e Bankës me një jetë të dobishme prej pesë vitesh.

### **2.11 Aktive afatgjata materiale të investuara**

Aktivitet afatgjata materiale të investuara janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qiraja dhe / ose për vlerësimin e kapitalit (duke përfshirë pronat në ndërtim për qëllime të tilla). Aktivitet afatgjata materiale të investuara njihen fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, këto aktive maten me vlerën e drejtë. Të gjitha interesat e Bankës mbi prona të mbajtura nën qiranë operative për të fituar të ardhura nga qiraja ose për qëllime vlerësimi kapitali njihen si aktive afatgjata materiale të investuara dhe të maten duke përdorur modelin e vlerës së drejtë. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve afatgjata materiale të investuara përfshihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato lindin. Një aktiv afatgjatë material i investuar çregjistrohet me nxjerrjen jashtë përdorimit ose kur aktivi i investuar tërhiqet përgjithmonë nga përdorimi dhe kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike. Çdo fitim ose humbje që rrjedh nga çregjistrimi i aktivitet material të investuar (llogaritur si diferencë midis të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël neto) përfshihet në fitim ose humbje në periudhën kur aktivi çregjistrohet. Aktivitet afatgjata materiale të investuara përfshijnë kolaterale të marra nga proceset ligjore, si toka, ndërtesa dhe ambiente biznesi, të cilat nuk përdoren nga Banka në veprimtarinë e saj kryesore.

### **2.12 Aktive të riposeduara**

Në rrethana të caktuara, prona riposedohet pas ekzekutimit të kredive që janë në mospagim. Pronat e riposeduara maten me më të voglën e vlerës së ankandit dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Qëllimi i Drejtimit është që të shesë sa më shpejt që të jetë e mundur pronat e riposeduara dhe të përdorë të ardhurat nga shitja për të reduktuar shumën e papaguar.

### **2.13 Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare**

Banka vlerëson në çdo datë raportimi ose më shpesh, nëse ka ngjarje ose ndryshime rrethanash që tregojnë se vlera e mbetur mund të jetë e zhvlerësuar, nëse ka tregues që një aktiv jofinanciar mund të jetë i zhvlerësuar. Kur ka tregues të tillë, ose kur është i nevojshëm testimi vjetor për zhvlerësim të aktivitet, banka vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitet. Kur vlera e mbetur e aktivitet (ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) tejkalon vlerën e rikuperueshme, aktivi (ose njësisë gjeneruese e mjeteve monetare) konsiderohet i zhvlerësuar dhe çregjistrohet deri në shumën e rikuperueshme.

Për aktivet me përjashtim të emrit të mirë, në çdo datë raportimi, kryhet një vlerësim për të parë nëse ka tregues që humbjet e zhvlerësimeve të njohura më parë mund të mos ekzistojnë më ose mund të jenë zvogëluar. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, vlerësohet shuma e rikuperueshme. Një humbje zhvlerësimi e njohur më parë rimerret vetëm nëse ka pasur ndryshime në vlerësimet e kryera për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivitet, që nga njohja e fundit e humbjes së zhvlerësimit. Në këtë rast, vlera e mbetur e aktivitet rritet deri në shumën e rikuperueshme deri në masën që rritja në vlerën e mbetur të aktivitet, përveç emrit të mirë që i takon rimarrjes së humbjes nga zhvlerësimi, nuk tejkalon vlerën e mbetur që do të vendosej (neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi) nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi në vitet e mëparshme.

## **2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.14 Kontrata të garancisë financiare**

Kontratat e garancisë financiare kërkojnë që emetuesi të kryejë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për humbje që ai ndesh si pasojë e mosshlyerjes të një huamarrësi të caktuar në datën e detyrimit, në përputhje me kushtet e instrumentit të borxhit.

Këto garanci financiare u jepen bankave, institucioneve financiare dhe organizatave të tjera për llogari të klientëve për të siguruar kredi, paradhënie dhe produkte të tjera bankare. Garancitë financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë në datën kur garancia jepet. Pas njohjes fillestare, detyrimet e bankës në sajë të këtyre garancive maten me vlerën më të madhe midis matjes fillestare, minus amortizimin e llogaritur për të njohur në fitim ose humbje tarifave të fituara në mënyrë lineare përgjatë jetës së garancisë dhe vlerësimit më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të shlyer çdo detyrim të garancisë financiare në datën e raportimit. Këto vlerësime përcaktohen në bazë të eksperiencës me transaksione të ngjashme dhe historikut të humbjeve, të mbështetur nga gjykimi i drejtimit. Çdo rritje në detyrim nga garancitë regjistrohet në fitim ose humbje si shpenzime të tjera operative.

Garancitë dhe angazhimet financiare për të dhënë kredi, njihen fillimisht me vlerën e drejtë, e cila evidentohet normalisht nga shumata e tarifave të marra. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare përgjatë jetës së angazhimit.

### **2.15 Pensione dhe përfitime të tjera pas punësimit**

Banka paguan kontribute në planet e pensioneve të punonjësve të saj sipas kërkesave të legjisllacionit vendas për sigurimet shoqërore. Detyrimet për pensione të Bankës, lidhen vetëm me plane me kontribut të përcaktuar. Planet me kontribut të përcaktuar, të bazuar mbi pagat, bëhen me institucionin e administruar nga Shteti (Instituti i Sigurimeve Shoqërore) përgjegjës për pagesën e pensioneve. Banka nuk ka detyrime të mëtejshme pas pagesës së kontributit. Kontributet përbëjnë kosto neto periodike për vitin në të cilin ato lindin dhe njihen si shpenzime personeli në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.

### **2.16 Provigjone**

Provigjonet njihen kur banka ka një detyrim aktual (ligjor apo konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe ka shumë mundësi që të ekzistojë një dalje burimesh që kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe shumata mund të matet me besueshmëri.

Kur ka një numër detyrimesh të ngjashme, mundësia e daljes së burimeve për shlyerje përcaktohet duke marrë në konsideratë kategorinë e detyrimit si të ishte një. Një provigjon njihet edhe nëse mundësia e daljes së burimeve në lidhje me çdo zë të përfshirë në të njëjtën kategori detyrimesh mund të jetë e vogël.

Provigjonet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që do të kërkohen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut në lidhje me vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të lidhura me detyrimin. Rritja në provigjon me kalimin e kohës njihet si shpenzim interesi.

**2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**2.17 Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin paraqitet në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në datën e raportimit. Shpenzimi i tatim fitimit përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse nëse nuk është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse kur lidhet me transaksione që njihen gjithashtu, në të njëjtën apo në një tjetër periudhë, në të ardhura gjithëpërfshirëse.

*Tatimi aktual*

Aktivitet dhe detyrimet aktuale tatimore për vitin në vazhdim dhe vitet e mëparshme maten me shumën që pritet të merret apo t'u paguhet autoriteteve tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore që përdoren për përlogaritjen e shumës janë ato që janë në fuqi në datën e raportimit. (2018: 15 %, 2017: 15%).

*Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë llogaritet kundrejt diferencave të përkohshme midis bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave kontabël për raportim financiar në datën e raportimit. Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme, përveç rasteve kur detyrimi i shtyrë tatimor rezulton nga njohja fillestare e emrit të mirë ose e një aktivi apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe, në kohën e transaksionit, nuk ndikon as fitim kontabël dhe as fitimin ose humbjen e tatueshme.

Aktivitet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme tatimore, kreditimet tatimore të papërdorura dhe humbjet tatimore të bartura, deri në masën që fitime të ardhshme të mundshme, kundrejt të cilave diferencat e përkohshme të zbritshme dhe kreditimet dhe humbjet tatimore të bartura mund të përdoren, do të jenë të disponueshme, përveç rasteve kur aktivi tatimor i shtyrë që lidhet me diferencat e përkohshme të zbritshme rezulton nga njohja fillestare e një aktivi apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi, dhe në kohën e transaksionit, nuk ndikon fitimin kontabël apo fitim ose humbjen e tatueshme.

Vlera kontabël e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën që nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë në dispozicion për të lejuar të gjithë ose një pjesë të aktivitetit tatimor të shtyrë që të shfrytëzohet.

Aktivitet e panjohura tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen në atë masë që është bërë e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të lejohet aktivitetit tatimor të shtyra që do të mbulohej. Aktivitet dhe detyrimet e shtyra tatimore maten me normat e tatimit që pritet të aplikohen në vitin kur aktivi realizohet ose shlyhet pasivi, bazuar në normat tatimore (dhe legjislacionin tatimor) që janë në fuqi ose që konsiderohet si i miratuar në datën e raportimit .

Aktivitet tatimore të shtyra dhe pasivet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e ligjshme që të kompensojë aktivitetit tatimore aktuale kundrejt pasiveve tatimore aktuale dhe tatimet e shtyra lidhen me të njëjtën njësi ekonomike dhe të njëjtin organ tatimor. Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen si detyrim dhe zbriten nga kapitali kur ato miratohen nga aksionarët e Bankës. Dividendët e ndërmjetëm janë zbritur nga kapitali kur deklarohen dhe nuk është më në diskrecionin e Bankës. Dividendët për vitin që janë miratuar pas datës së raportimit janë paraqitur si një ngjarje pas datës së raportimit.

## **2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **2.18 Informacion krahasues**

Disa informacione shpjeguese janë riklasifikuar ose ndryshuar në pasqyrat e reja financiare për të reflektuar një efekt më të mire të llogarive. Teprica e tatim fitimit të parapaguar është paraqitur në vlerë neto duke përfshirë zhvlerësimin që ishte klasifikuar në provigjone të tjerë në 2017 (shih shënimin 23). Llogaritë pezull të përfshira në aktive të tjera dhe në detyrime të tjera janë paraqitur në vlerë neto (shih shënimin 19 dhe 22).

### **3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël**

Banka kryen vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë për ngjarje të ardhshme që mendohet se janë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

#### *(a) Humbje nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve*

Banka rishikon portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin të paktën çdo tre muaj. Në përcaktimin nëse një humbje zhvlerësimi duhet të regjistrohet ose jo në fitim ose humbje, banka kryen gjykime nëse ekzistojnë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare nga një portofol kredish para se rënia të identifikohet me një kredi individuale në po atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në gjendjen e pagesave të kredimarrësve në një bankë, ose kushte kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen drejtpërdrejtë me mosshlyerje të aktiveve në një bankë. Menaxhimi përdor vlerësime të bazuara në eksperiencën historike të humbjeve për aktivet me karakteristika të ngjashme të riskut kreditor dhe të evidencës objektive të zhvlerësimit në portofol kur projektohen flukset e ardhshme monetarë.

Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si shumë ashtu edhe kohën e flukseve të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar çdo diferencë që ekziston midis vlerësimeve të humbjeve dhe eksperiencës faktike të humbjes. Në masën që vlera aktuale neto e flukseve të ardhshme ndryshon me  $\pm 5\%$ , provigjoni i bankës do të përllogaritet 387,441 mijë Lekë më i lartë ose 395,815 mijë Lekë më i ulët (2017: 206,343 mijë Lekë më i lartë ose 205,507 mijë Lekë më i ulët).

#### *(b) Pozicion tatimor i pasigurtë*

Pozicionet tatimore të pasigurta të Bankës rivlerësohen nga Drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet për pozicionin e tatim fitimit përcaktohen nga Drejtimi si më i ngjashmi që mund të jetë në mënyrë që të mos rezultojë në detyrime tatimore të tjera që mund të ngrihen nëse pozicioni do të vihej në dyshim nga organet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretime të ligjeve tatimore që janë në fuqi ose konsiderohen në fuqi në fund të periudhës raportuese, dhe të çdo vendim gjykate të njohur ose rregulloreje. Detyrimet nga gjoba, interesa dhe taksa të tjera përveç atyre mbi të ardhurat njihen në bazë të gjykimeve të menaxhimit mbi shpenzimin e nevojshëm për të mbyllur detyrimin në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë 2018, Banka ka qenë subjekt i një kontrolli nga autoritetet tatimore siç është përshkruar në shënimin 12.

#### *(c) Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Informacioni mbi vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare që është përcaktuar nga gjykime dhe nuk është bazuar në të dhëna të observueshme në treg, paraqitet në shënimin 2.5.



#### **4 Adoptimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretime**

(a) Standarde dhe interpretime efektive për periudhën aktuale

Amendimet e mëposhtme të standardeve të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë efektive për periudhën aktuale të raportimit.

- **SNRF 15 “Të ardhura nga kontratat me klientët” dhe ndryshime të tjera (efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas 1 janar 2018).**

SNRF 15 ka vendosur një model të vetëm gjithëpërfshirës për tu përdorur në kontabilizimin e të ardhurave që lindin nga kontratat me klientët. SNRF 15 ka zëvendësuar udhëzimin e njohjes së të ardhurave të përfshirë SNK 18 “Të ardhurat”, SNK 11 “Kontratat e ndërtimit” dhe interpretimet që lidhen me to. SNRF 15 ka vendosur parimet që një njësi ekonomike duhet të aplikojë për të raportuar informacion të dobishëm përdoruesve të pasqyrave financiare lidhur me natyrën, shumën, kohën dhe pasigurinë të ardhurave dhe flukseve monetare që lindin nga kontratat me klientët. Standardi i ri do të aplikohet mbi të gjithë kontratat me klientët, përveç atyre kontratave që mbulohen nga standarde të tjera si instrumentet financiare, qira financiare.

Qasja për njohjen e të ardhurave siç parashikohet nga SNRF 15 përfshin pesë hapa:

- Identifikimi i kontratave me klientët
- Identifikimi i performancës së detyrimit në kontrata
- Përcaktimi i çmimit të transaksionit
- Alokimi i çmimit të transaksionit te performanca e detyrimeve në kontrata
- Njohja e të ardhurave kur njësia ekonomike përmbush një detyrim për të performuar

Linja kryesore e të ardhurave të Bankës është “E ardhura nga interesi” që nuk mbulohet nga SNRF 15. Banka aplikon SNRF 15 në njohjen e të ardhurave nga:

- Komisionet bankare
- Të ardhura të tjera operative

Aplikimi për here të pare i SNRF 15 më 1 janar 2018

Banka ka kryer një test për vlerësimin e ndikimit të SNRF 15 më 1 janar 2018. Sipas rezultateve të testit, SNRF 15 nuk do të ketë asnjë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës. Edhe pse dy kategoritë e mësipërme mbulohen nga SNRF 15, bazuar në rezultatet e testit, nuk do të ketë asnjë ndryshim në trajtimin kontabël.

#### **5 Standarde të publikuara, por ende jo efektive**

Një numër standardesh të reja, amendime standardesh dhe interpretime nuk janë akoma efektive për periudhat që fillojnë nga ose pas 1 janar 2018, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Banka planifikon të adoptojë këto shpallje kur ato të bëhen efektive.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat raportuese duke filluar më ose pas 1 janar 2019). Standardi i ri vendos parime për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirave. Pothuajse në të gjitha qiratë, qiramarrësi merr të drejtat për të përdorur aktivin në fillim të qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen gjatë periudhës duke marrë financim. Përkatësisht, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira e zakonshme ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model kontabiliteti me një qiramarrës të vetëm. Qiramarrësit do të kërkohen që të njohin: (a) aktive dhe detyrime për të gjitha qiratë me një kohëzgjatje me të madhe se 12 muaj, vetëm në rast se aktiviteti ka vlerë të ulët atëherë kjo kërkesë mund të mos zbatohet dhe (b) amortizimin e aktiveve të kredisë veç interesave të detyrimeve të qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse.

**5 Standarde të publikuara, por ende jo efektive (vazhdim)**

Në thelb, SNRF 16 vazhdon kërkesat kontabël për qiradhënësit të SNK 17. Prandaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë si qira të zakonshme ose qira financiare, dhe t'i kontabilizojë këto dy tipe qirash ndryshe.

Banka vendosi që do të zbatojë standardin nga data e tij e zbatimit të detyrueshëm, 1 janar 2019, duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, pa riparaqitje të shumave krahasuese. Detyrimi i qirasë në datën e zbatimit fillestar është në shumën prej 544,565 mijë Lekë. Aktivitetet me të drejtë përdorimi maten në tranzicion në shumën e detyrimit të qirasë të rregulluar për shumën e parapagimit, në shumën prej 573, 652 mijë Lekë. Tabela e mëposhtme paraqet një rakordim të angazhimeve të qirave të zakonshme të shpalosur në shënimin 29 të detyrimit të njohur:

**31 dhjetor 2018 / 1  
janar 2019**

Pagesat totale minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të pa-anulueshme (shënimi 29)	551,966,506
- Pagesat e ardhshme të qirasë përfshirë opsionin e zgjatjes së periudhës së qiramarrjes	544,564,639
- Pagesat e ardhshme të qirasë së ndryshueshme që bazohen në një indeks ose një normë	-
- Efekti i skontimit në vlerën aktuale	7,401,867

Ndryshime që mund të jenë të rëndësishme për Bankën, por që nuk priten që të kenë ndonjë ndikim domethënës në pasqyrat financiare, janë si më poshtë:

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Bankës ose Sipërmarrjes së Përbashkët të tij - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).
- SNRF 17 “Kontratat e Sigurimeve” (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- KIRFN 23 “Paqartësi mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat” (publikuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshimet në SNRF 9 (publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 “Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja” (publikuar më 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Përcaktimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

**6 Menaxhimi i rrezikut financiar**

Aktivitetet e bankës e ekspozojnë atë me rreziqe të ndryshme financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e një shkalle të caktuar rreziku apo kombinimi rreziqesh. Pranimi i rrezikut është i rëndësishëm në biznesin financiar, dhe rreziqet operationale janë një rrjedhojë e pashmangshme e të qenurit në biznes. Synimi i bankës është të arrijë një tepricë midis rrezikut dhe kthimit dhe të minimizojë ndikimet e mundshme negative në performancën financiare të bankës.

## **6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Politikat e bankës për menaxhimin e rrezikut janë hartuar për të identifikuar rreziqet, për të përcaktuar kufijtë dhe kontrole të përshtatshme rreziku dhe për të monitoruar rreziqet dhe përputhjen me kufijtë nëpërmjet sistemeve të besueshme dhe të përditësuara të informacionit. Banka rishikon rregullisht politikat e saj të menaxhimit të rrezikut dhe sistemet për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikatat e reja më të mira. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga një departament risku në Bankë dhe nga politika të miratuara nga Bordi i Drejtorëve. Bordi ofron parime të shkruara për menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut si dhe politika të shkruara në lidhje me fusha specifike si rreziku kreditor, rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit dhe rreziku i likuiditetit.

Për më tepër, auditimi i brendshëm është përgjegjës për rishikimin e pavarur të menaxhimit të rrezikut dhe ambientit të kontrollit. Llojet më të rëndësishme të rrezikut janë rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit, rreziku i tregut dhe rreziqe të tjera operationale. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e monedhës, të normës së interesit dhe të çmimeve të tjera.

### **6.1 Rreziku kreditor**

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes për Bankën, që rrjedh nga mosshlyerja e mundshme e kundërpartisë në përmbushjen e detyrimeve të saj kontraktuale. Tirana Bank analizon spektrin e plotë të rrezikut kreditor duke përfshirë nënkategoritë e tij të tilla si rreziku i kredidhënies, rreziku i kundërpartisë, rreziku i emetuesit, rreziku i shlyerjes, rreziku i përqendrimit, rreziku i tërthortë kreditor nga kursi i këmbimit, rreziku sovran dhe rreziku i mbetur. Një vlerësim i tillë është përkthyer në vlerësimin e brendshëm të nevojës për kapital për rrezikun kreditor. Rreziku kreditor është rreziku me material për bankën që konsumon pjesën më të madhe të kapitalit minimal dhe kryesisht rrjedh nga aktivitetet e huadhënies (huatë dhe paradhëniet) ndaj klientëve dhe investimet në letrat me vlerë të borxhit siç paraqiten në strukturën e saj të bilancit. Ekspozimet në dhe jashtë bilancit analizohen sipas humbjeve të mundshme që ato mund të prodhojnë dhe provigjonohen në përputhje me metodologjitë e dokumentuara të provigjonimit të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.

Parimet e Bankës për Qeverisjen e Korporatave sigurojnë alokimin e duhur të përgjegjësisë dhe llogaridhënies bazuar në origjinën e rrezikut, me qëllim që të harmonizojë procesin e marrjes së rrezikut me oreksin e rrezikut.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut kreditor monitorohet rregullisht në lidhje me oreksin e miratuar të rrezikut, duke siguruar që profili i rrezikut të Bankës të mbetet brenda niveleve të pranueshme. Devijimet, nëse ka, nga oreksi i rrezikut raportohen në Bordin e Drejtorëve.

Objektivat kryesorë të menaxhimit të rrezikut kreditor janë:

- 1) Përcaktimi i politikave të centralizuara harmonizuar me Politikat e Grupit dhe në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore;
- 2) Monitorimi i portofolit të Bankës;
- 3) Menaxhimi aktiv i rrezikut për të identifikuar dhe analizuar herët atë;
- 4) Krijimi i funksioneve të menaxhimit të rrezikut të pavarur nga vija tregtare e biznesit;
- 5) Integrimi i funksionit të menaxhimit të rrezikut në procesin e organizimit të biznesit;
- 6) Raportimi për rrezikun përmes organizatës.

Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut kreditor është përgjegjës për:

- Zhvillimin e sistemeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të rrezikut kreditor: analiza e rezultateve dhe raportimi tek drejtimi;
- Përgatitjen e Bankës për implementimin e Bazel II;
- Marrëdhëniet me Bankën e Shqipërisë (Banka Qendrore), Piraeus Bank dhe/ose autoritete të tjera në lidhje me efektivitetin e Menaxhimit të Rrezikut Kreditor.

Komiteti i auditimit dhe departamenti i auditimit të brendshëm ndjekin përputhshmërinë me politikat dhe procedurat.

**6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

**6.1.1 Matja e rrezikut kreditor**

Proçedurat e përshkruara më poshtë lidhen me matjen e rrezikut kreditor me qëllim operacional si dhe me raportimin sipas rregullores të Bankës së Shqipërisë. Humbjet e zhvlerësimit të huave dhe paradhënieve për raportim financiar përcaktohen duke ndjekur proçedurat e përshkruara në Shënimin 6.1.3.

*(a) Hua dhe paradhënie*

Në matjen e rrezikut kreditor të huave dhe paradhënieve për klientët dhe bankat në nivel palësh, banka pasqyron tre përbërës (i) ‘mundësinë e mos arritjes’ nga klienti apo palë të tjera për përmbushjen e detyrimeve; (ii) ekspozimet aktuale ndaj palës tjetër dhe zhvillimet e mundshme të ardhshme, nga të cilat banka ‘ekspozohet ndaj mosshlyerjes’; dhe (iii) normën e mundshme të rimarrjes nga detyrimet e dështuara (‘mosshlyerja i kaluar në humbje’).

- (i) Banka vlerëson mundësinë e mosshlyerjes të palëve individuale duke përdorur pajisje të brendshme të renditjes për kategori të ndryshme palësh. Ato janë krijuar nga vetë banka dhe kombinojnë analiza statistikore me gjykimin e oficerit të kredisë të cilat konfirmohen me të dhëna të jashtme të disponueshme, kur është e nevojshme. Klientët e bankës segmentohen në 5 kategori. Shkalla e renditjes së bankës në vijim pasqyron gamën e mundësive të mosshlyerjes të përcaktuar për çdo kategori. Kjo do të thotë që në parim, ekspozimet mund të lëvizin ndërmjet kategorive me ndryshimin e vlerësimit të mundësive të tyre për mosshlyerje të detyrimeve. Pajisja e renditjes rishikohet dhe përditësohet sipas nevojës. Banka verifikon rregullisht performancën e renditjes dhe fuqinë e tyre parashikuese në lidhje me mosshlyerjen e detyrimeve.

**Shkalla e renditjes së brendshme të Bankës**

<b>Renditja e Bankës</b>	<b>Përshkrimi</b>
A	Investim
B	Standard
C	Monitorim i veçantë
D	Nënstandard
E	Të dyshimtë dhe të humbur

Kriteri për klasifikimin e aktiveve financiare në grupet A, B, C, D dhe E janë si vijon:

Aktivet financiare klasifikohen në Grupin **A** nëse ato u janë dhënë debitorëve të cilët vlerësohen në renditje investimi nga vlerësues të jashtëm, për shembull Moody’s, S&P, Fitch, pavarësisht renditjes së brendshme. Banka nuk ka klient të tillë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

Aktivet financiare klasifikohen në Grupin **B** nëse janë kundrejt:

- Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë Shqiptare;
- debitorë të cilët nuk kanë mundësi mosshlyerje dhe që ripaguajnë detyrimet e tyre brenda maturitetit ose me vonesë deri në 30 ditë; dhe
- ekspozimet e siguruara duke vendosur kolateral të renditur si kolateral i klasës të parë.

Aktivet financiare klasifikohen në Grupin **C** nëse janë kundrejt debitorëve:

- flukset monetare të cilëve vlerësohen si të përshtatshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht pozicionit financiar aktual i cili vlerësohet i dobët, pa shenja të përkeqësimit të mëtejshëm në të ardhmen; dhe
- të cilët shlyejnë detyrimet e tyre me vonesa deri në 30 ditë dhe me raste nga 31 deri 90 ditë.

**6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

**6.1.1 Matja e rrezikut kreditor (vazhdim)**

Aktivitetet financiare klasifikohen në Grupin **D** nëse janë kundrejt debitorëve:

- për të cilët vlerësohet se flukset monetare nuk do të jenë të mjaftueshme për ripagesa të rregullta të detyrimeve të matura;
- të cilët shlyejnë detyrimet e tyre me vonesa deri 90 ditë, me raste nga 91 deri 180 ditë;
- të cilët janë dukshëm me mungesë kapitalizimi;
- të cilët nuk kanë burime të mjaftueshme kapitali afatgjatë për të financuar investimet afatgjata; dhe
- prej të cilëve banka nuk pret të marrë informacion aktual të kënaqshëm apo dokumentim të përshtatshëm në lidhje me ripagesat e detyrimeve.

Aktivitetet financiare klasifikohen në Grupin **E** nëse janë kundrejt debitorëve:

- për të cilët ekziston një mundësi e lartë humbjeje të një pjese të aktivitetit financiar;
- të cilët shlyejnë detyrimet e tyre me vonesë më shumë se 90 deri 180 ditë, me raste nga 181 deri 360 ditë;
- të cilët kanë paaftësi paguese;
- për të cilët ka filluar një lëvizje për nisje të procesit të likuidimit ose deklarimit të falimentimit e cila është në proces gjyqësor;
- të cilët janë në proces reformimi ose likuidimi;
- të cilët kanë deklaruar falimentim;
- prej të cilëve nuk priten ripagesa; dhe
- me baza ligjore të diskutueshme.

(ii) Ekspozimi nga mosshlyerja bazohet mbi shumat që banka pret të arkëtojë në kohën e mosshlyerjes së detyrimit. Për shembull, për një kredi është vlera nominale. Për një angazhim, banka përfshin shumën e tërhequr plus shumat e mëtejshme që mund të tërhiqen deri në kohën e mosshlyerjes, nëse ndodh.

(iii) Humbjet në rastin e mosshlyerjes së kredisë paraqesin pritshmërinë e bankës për shtrirjen e këtryre humbjeve, në rastin e mosshlyerjes së kredisë. Kjo shprehet si përqindje humbjeje për njësi ekspozimi dhe ndryshon sipas llojit të palës tjetër, llojit dhe vjetërsisë së ankesës dhe disponueshmërisë së kolateralit dhe mjeteve të tjera zbutëse të kredisë.

*(b) Letrat me vlerë të borxhit dhe të tjera*

Për instrumente borxhi dhe të tjera, departamenti i riskut përdor renditje që varen nga emetuesi, Qeveria Shqiptare. Investimet në këto letra me vlerë dhe bono thesari shikohen si një mënyrë për të fituar cilësi dhe për të mbajtur në të njëjtë kohë një burim të disponueshëm për të përmbushur kërkesat për fonde.

Investimet lejohen vetëm për instrumente likuide me renditje të lartë kredie. Duke qenë se këto instrumente kanë renditje të lartë kredie, banka nuk pret që palët do të dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre. Ekspozimi maksimal kundrejt rrezikut kreditor përfaqësohet nga shumata e çdo aktiviteti financiar në bilanc.

## **6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

### **6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

#### **6.1.2 Kontrolli i kufirit të rrezikut dhe politikat e shmangies**

Banka menaxhon, kufizon dhe kontrollon përqendrimet e rrezikut kreditor kudo që ato identifikohen – në veçanti, për palë individuale dhe grupe dhe për industri dhe vende.

Banka strukturon nivelet e rrezikut kreditor që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime mbi shumat e pranuara të rrezikut në lidhje me një huamarrës dhe në lidhje me segmentimet gjeografike dhe industriale. Këto rreziqe monitorohen rast pas rasti dhe janë subjekt i një rishikimi vjetor dhe më të shpeshtë kur është e nevojshme. Kufijtë në lidhje me nivelet e rrezikut kreditor sipas produkteve dhe sektorëve të industrisë miratohen nga Bordi i Drejtorëve.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor menaxhohet përmes analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përmbushur detyrimet e tyre për ripagesat e interesit dhe principalit dhe duke ndryshuar kufijtë e kreditimit kur është e nevojshme.

Disa masa specifike për kontroll dhe shmangie paraqiten në vijim.

#### *a) Kolaterali*

Banka zbaton një sërë politikash dhe praktikash për të zvogëluar riskun kreditor. Më tradicionale mes tyre është marrja e siguruesve për paradhëniet si praktikë e zakonshme.

Banka zbaton udhëzime mbi pranueshmërinë e kategorive specifike të kolateralit ose shmangie të rrezikut kreditor. Llojet kryesore të kolateralit për huatë dhe paradhëniet janë:

- Paraja, garanci bankare dhe e kompanive të klasës së parë;
- Hipotekë mbi pasuritë rezidenciale;
- Peng mbi aktivet e biznesit si ndërtesa, inventarë, llogari të arkëtueshme; dhe
- Peng mbi instrumente financiare si instrumente borxhi dhe kapitali.

Huatë ndaj korporatave dhe individëve përgjithësisht janë të siguruara; paradhëniet dhe kartat e kreditit për individët janë të siguruara me depozita dhe kolateral në rastin e klientëve kredie deri në shumën e plotë të principalit, interesave dhe shpenzimeve të tjera. Për më tepër, në mënyrë që të minimizohet humbja e kredisë, banka kërkon kolateral shtesë nga palët sapo vihen re tregues për zhvlerësim për huatë dhe paradhëniet individuale përkatëse. Instrumentet e borxhit, bonot e thesarit dhe instrumente të ngjashëm janë përgjithësisht të pasiguar.

#### *b) Kushtëzime të lidhura me huanë*

Qëllimi kryesorë i këtyre instrumenteve është sigurimi i fondeve për klientin sipas kërkesave. Letrat e garancisë dhe ato pezull të kredisë kanë të njëjtin rrezik kredie si huatë dhe sigurohen me po atë kolateral si huatë. Letrat dokumentare dhe tregtare të kredisë, të cilat janë angazhime të shkruara të bankës për llogari të klientit, ku një palë e tretë autorizohet të tërheqë shuma të specifikuar në bankë, kolateralizohen me dërgesën përkatëse të mirave dhe mbartin kështu më pak risk sesa një hua e drejtpërdrejtë. Angazhimet për të zgjeruar huanë paraqesin pjesë të papërdorur të autorizimit për të zgjeruar kredinë në formë huaje, garancie, letra kredie. Në lidhje me rrezikun kreditor mbi angazhimet për të zgjeruar kredinë, banka është e ekspozuar ndaj humbjes së shumës së barabartë me angazhimin e papërdorur.

Megjithatë, shumat e mundshme e humbjes është më e vogël se angazhimet e papërdorura, meqenëse shumë angazhime për zgjerim kredie janë të kushtëzuara në sajë të ruajtjes së standardeve specifike të kreditimit nga klientët. Banka monitoron afatin deri në maturim të angazhimit të kredisë duke qenë se angazhimet me afat më të gjatë kanë një shkallë më të lartë rreziku krahasuar me angazhimet afatshkurtra.

**6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

**6.1.3 Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit**

Banka duhet të njohë rezervë për humbjet e pritshme të kredisë për një aktiv financiar, një kontratë qiraje, një kontratë nga e cila rrjedhin të drejta apo për një garanci financiare, për të cilat zbatohen kërkesat për zhvlerësim.

Aktivet financiare subjekt i përlogaritjes të zhvlerësimit janë si më poshtë:

- a) aktivet financiare të matura me koston e amortizuar
- b) aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
- c) arkëtimet e qirasë
- d) Kontratat e së drejtës
- e) angazhimet e kredisë për të akorduar një kredi me një kontratë të garancisë financiare nën normën e interesit të tregut

**6.1.3.1 Matja e humbjes së pritshme nga kredia (HPK)**

Banka mat humbjet e pritshme nga një instrument financiar në një mënyrë që reflekton:

- a) një rezultat të pavarur, matur duke përdorur mesatare të ponderuar të rezultateve të ngjarjeve me probabilitete të ndryshme;
- b) vlerën në kohë të parasë; dhe
- c) informacion të arsyeshëm dhe të argumentuar (faktuar) që banka disponon pa kosto ose përpjekje të shtuara në datën e raportimit për ngjarje të kaluara, aktuale si dhe parashikimet ekonomike për të ardhmen.

Humbjet e pritshme të kredisë janë një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë (shembull: Vlera aktuale e të gjitha humbjeve në cash) gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Humbjet e pritshme janë diferenca midis flukseve monetare që banka duhet të marrë në përputhje me kontratën dhe flukseve monetare që Banka pret të marrë. Për shkak se humbjet e pritshme të kredisë konsiderojnë shumën dhe kohën e pagesave, humbja e kredisë lind edhe nëse Banka pret që të paguhet plotësisht por më vonë se data e pagesës sipas kushteve kontraktuale.

**6.1.3.2 Rritje e konsiderueshme në rrezikun kreditor**

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse rreziku kreditor për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare e aktivitetit. Gjatë vlerësimit, Banka përdor ndryshimin në rrezikun e mospagimit që ndodh gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar në vend të ndryshimit në shumën e humbjeve të pritshme nga kredia. Për këtë vlerësim, krahasohet probabiliteti i mospagimit në pagim të instrumentit financiar në datën e raportimit financiar me probabilitetin e mospagimit në datën e njohjes fillestare, çka mund të jetë indikacion për rritje të konsiderueshme në rrezikun kreditor, duke u mbështetur në informacione të arsyeshme, të siguruara pa kosto dhe përpjekje të shtuara. Rreziku kreditor të një instrumenti financiar konsiderohet i ulët nëse instrumenti financiar ka një rrezik të ulët të mosshlyerjes në pagesa, huamarrësi ka aftësi të mirë për të përmbushur detyrimet kontraktuale në afat të shkurtër dhe ndryshimet e pafavorshme të kushteve ekonomike dhe të biznesit në afatgjatë mundet, por jo domosdoshmërisht, të zvogëlojnë aftësinë e huamarrësit për të përmbushur detyrimet kontraktuale.

Instrumentet financiare nuk konsiderohen të kenë rrezik të ulët kreditor thjesht për shkak të vlerës së kolateralit kur instrumenti financiar pa atë kolateral nuk do të konsiderohej me rrezik të ulët kreditor.

**6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

**6.1.3 Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit (vazhdim)**

**6.1.3.2 Rritje e konsiderueshme në rrezikun kreditor (vazhdim)**

Instrumentet financiare gjithashtu nuk konsiderohen të kenë rrezik të ulët kreditor vetëm për shkak se ata kanë një rrezik më të ulët krahasimisht me instrumentet e tjera financiare të Bankës ose në raport me rrezikun e kreditit të vendit ku banka operon. Nëse informacion i arsyeshëm dhe i faktuar mund të disponohet pa kosto ose përpjekje të shtuara, Banka nuk duhet të mbështetet vetëm në informacionet e kaluara për të përcaktuar nëse rreziku kreditor është rritur dukshëm që nga njohja fillestare. Sidoqoftë, kur informacion më largpamës (forward-looking) se sa statusi “në vonesë” (qoftë në baza individuale ose kolektive) nuk është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të shtuara, Banka mund të përdorë informacionet mbi ngjarje të ndodhura për të përcaktuar nëse ka pasur rritje të ndjeshme në rrezikun kreditor që nga njohja fillestare. Pavarësisht nga mënyra se si Banka vlerëson rritjen e ndjeshme të rrezikut kreditor, ekziston supozimi i arsyeshëm që rreziku kreditor për një aktiv financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare kur pagesat kontraktuale janë me shumë se 30 ditë në vonesë. Banka mund të kundërshtojë këtë supozim në qoftë se ka informacione të arsyeshme dhe të faktuara në dispozicion pa kosto ose përpjekje të shtuara, që tregojnë se rreziku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare edhe pse pagesat kontraktuale janë më shumë se 30 ditë në vonesë. Kur ajo përcakton se ka pasur rritje të ndjeshme në rrezikun kreditor para se pagesat kontraktuale të jenë mbi 30 ditë në vonesë, ky supozim nuk aplikohet.

**6.1.3.3 Koha e matjes së humbjeve të pritshme të kredisë**

Në çdo datë raportimi, Banka mat fondin rezervë për humbjet për një instrument financiar në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetës së instrumentit nëse rreziku kreditor për atë instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

Në rast se në datën e raportimit, rreziku kreditor për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duhet të matet fondi rezervë për humbjet e pritshme nga kredia për një periudhë 12 mujore.

**6.1.3.4 Çështje lidhur me llogaritjen e humbjes së pritshme nga kredia**

**6.1.3.4.1 Çregjistrimi**

Para vlerësimit nëse dhe në çfarë mase është i përshtatshme çregjistrimi, Banka përcakton nëse çregjistrimi duhet të zbatohet për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjese të një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) ose një aktiv financiar (ose një grupi të ngjashme financiare) në tërësinë e tij, si më poshtë:

- a) Çregjistrimi aplikohet për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjese të një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) nëse dhe vetëm nëse pjesa që konsiderohet për mosnjohje plotëson një nga tre kushtet e mëposhtme.
  - i. Pjesa përfshin vetëm flukse monetare të identifikuar në mënyrë specifike nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme).
  - ii. Pjesa përbën vetëm një pjesë proporcionale (pro rata) të flukseve të mjeteve monetare nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme).
  - iii. Pjesa përbën vetëm një pjesë proporcionale (pro rata) të flukseve monetare të identifikuar në mënyrë specifike nga një aktiv financiar (ose një grup aktivesh financiare të ngjashme).



## **6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

### **6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

#### **6.1.3 Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit (vazhdim)**

##### **6.1.3.4 Çështje lidhur me llogaritjen e humbjes së pritshme nga kredia**

###### **6.1.3.4.1 Çregjistrimi (vazhdim)**

- b) Në të gjitha rastet e tjera, çregjistrimi zbatohet për aktivin financiar në tërësinë e tij (ose grupin e aktiveve financiare të ngjashme në tërësinë e tyre).

Banka çregjistron një aktiv financiar vetëm kur:

- a) përfundon afati i të drejtave kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar, ose
- b) transferon aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

Ne çregjistrimin e një aktivi financiar në tërësinë e tij, diferenca midis:

- a) vlerës kontabël (e matur në datën e çregjistrimit) dhe
- b) shumës së marrë (duke përfshirë çdo aktiv të ri të marrë minus çdo detyrim i ri i marrë) duhet të regjistrohet në fitim ose humbje.

Nëse aktivi i transferuar është pjesë e një aktivi financiar më të madh dhe pjesa e transferuar kualifikohet për çregjistrim në tërësinë e saj, vlera kontabël e mëparshme e aktivitetit më të madh financiar ndahet midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që është çregjistruar mbi bazën e vlerave të drejta përkatëse të pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, një aktiv i ruajtur do të trajtohet si një pjesë që vazhdon të njihet. Ndryshimi midis:

- a) vlerës kontabël (e matur në datën e çregjistrimit) të alokuar për pjesën e çregjistruar dhe
- b) shumës të marrë për pjesën e çregjistruar (duke përfshirë çdo aktiv të ri të marrë minus detyrime të reja) duhet të regjistrohet si fitim ose humbje.

###### **6.1.3.4.2 Instrumenta të blerë ose të origjinuar nga zhvlerësimi i kredisë**

Për instrumentet e blerë ose të origjinuar nga zhvlerësimi i kredisë, humbjet e pritshme të kredisë do të skontojnë duke përdorur normën efektive të interesit të rregulluar, të përcaktuar në momentin e njohjes fillestare.

Në datën e raportimit, Banka do të njohë vetëm ndryshimet kumulative nga humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë që në momentin e njohjes fillestare, si humbje e lejuar nga instrumentet e blerë ose të origjinuar nga zhvlerësimi i kredisë.

Në çdo datë raportimi, Banka do të njohë në fitim ose humbje shumën e ndryshimit në humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë si një fitim ose humbje nga zhvlerësimi. Banka njeh ndryshimet e favorshme në humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë si fitim nga zhvlerësimi, edhe nëse humbjet e pritshme gjatë jetës janë më të vogla se shuma e humbjeve të pritshme të kredisë që janë përfshirë në vlerësimin fillestar të flukseve të pritshme.

###### **6.1.3.4.3 Aktive financiare të zhvlerësuara**

Një aktiv financiar është i zhvlerësuar kur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim negativ në flukset monetare të ardhshme të aktivitetit financiar kanë ndodhur. Dëshmia se një aktiv financiar është i zhvlerësuar përfshin të dhënat e vëzhgueshme në lidhje me ngjarjet e mëposhtme:

- a) vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose huamarrësit;
- b) një shkelje të kontratës, siç është një ngjarje mos arritje për të paguar apo vonesë;

**6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

**6.1.3 Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit (vazhdim)**

**6.1.3.4 Çështje lidhur me llogaritjen e humbjes së pritshme nga kredia**

**6.1.3.4.3 Aktive financiare të zhvlerësuara (vazhdim)**

c) Huadhënësi, për arsye ekonomike ose kontraktuale që lidhen me vështirësitë financiare të huamarrësit, i ka dhënë këtij të fundit një facilitet pagese që huadhënësi nuk do ta jepte në kushte të tjera;

d) është e mundur që huamarrësi të hyjë në falimentim ose riorganizim tjetër financiar;

e) zhdukjen e një tregu aktiv për atë aktiv financiar për shkak të vështirësive financiare; ose

f) blerjen ose emetimin e një aktivi financiar me shume zbritje që pasqyron humbjet e ndodhura të kredisë.

Mund të mos jetë e mundur të identifikohet një ngjarje e vetme – në te kundërt, efekti i kombinuar i disa ngjarjeve mund të shkaktojë zhvlerësim të një aktivi financiar.

**6.1.3.4.4 Kolektive përkundrejt individuale**

Për të përmbushur objektivin e vlerësimit të humbjeve të pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë së aktivitetit financiar për rastet me rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor nga njohja fillestare, mund të jetë e nevojshme realizimi i vlerësimit mbi baza kolektive, duke konsideruar informacionin që sinjalizojnë rritje të rrezikut kreditor, për shembull, mbi një grup ose nën-grup instrumentesh financiare. Kjo është për të siguruar që Banka të përmbushë objektivin e vlerësimit të humbjeve të pritshme të kredisë gjatë jetës së aktivitetit, kur ka rritje të ndjeshme në rrezikun kreditor, edhe nëse nuk ka ende në nivele individuale sinjale për rritje të tillë të rrezikut kreditor.

Përgjithësisht pritet që humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë të njihen përpara se një instrument financiar të jetë në vonesë. Tipikisht, rreziku kreditor rritet ndjeshëm përpara se një instrument financiar të shfaqë vonesa ose të evidentohen ngjarje të tjera të lidhura me huamarrësin (për shembull, një modifikim ose ristrukturim). Rrjedhimisht, kur informacioni i arsyeshëm dhe i faktuar që është më largpamës se informacioni i ndodhur është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të shtuara, ai duhet të përdoret për të vlerësuar ndryshimet në rrezikun kreditor.

Megjithatë, në varësi të natyrës së instrumenteve financiare dhe informacionit të rrezikut kreditor në dispozicion për grupe të veçanta të instrumenteve financiare, Banka mund të mos jetë në gjendje të identifikojë ndryshime të rëndësishme në rrezikun kreditor për instrumente financiare individuale përpara se instrumenti financiar të jetë në vonesë. Ky mund të jetë rasti i instrumenteve financiare siç janë kreditë e tregtueshme për të cilat ka pak ose aspak informacion të përditësuar të rrezikut kreditor të marrë dhe monitoruar në mënyrë rutinore mbi baza individuale, deri sa klienti shfaq shkelje të kushteve kontraktuale. Nëse ndryshimet në rrezikun kreditor për instrumente financiare individuale nuk identifikohen përpara se ato të jenë në vonesë, një fond rezervë bazuar vetëm në informacionin mbi kredinë në nivel instrumenti financiar individual nuk do të përfaqësonte ndryshimet në rrezikun kreditor që nga njohja fillestare. Në disa rrethana, Banka nuk ka informacion të arsyeshëm dhe të faktuar në dispozicion të siguruar pa kosto ose përpjekje shtesë për të matur humbjet e pritshme të kredisë gjatë jetës së asetit në baza individuale. Në këtë rast, humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetës së aktivitetit duhet të njihen në baza kolektive, të cilat konsiderojnë të dhëna gjithëpërfshirëse të rrezikut kreditor. Ky informacion gjithëpërfshirës për rrezikun kreditor duhet të përfshijë jo vetëm informacionin e kaluar (ndodhur), por edhe të gjitha informacionet relevante të kredisë, duke përfshirë informacionin makroekonomik të pritshëm, me qëllim përafrimin e rezultatit të njohjes së humbjeve të pritshme të kredisë gjatë jetës, kur ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare në nivel instrumenti individual.

**6 Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

**6.1.3 Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit (vazhdim)**

**6.1.3.4 Çështje lidhur me llogaritjen e humbjes së pritshme nga kredia (vazhdim)**

**6.1.3.4.4 Kolektive përkundrejt individuale (vazhdim)**

Me qëllim përcaktimin e rritjeve të konsiderueshme në rrezikun kreditor dhe njohjen e një fondi rezervë për humbjet në baza kolektive, Banka grupon instrumentet financiare në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut kreditor me objektiv realizimin një analizë që mundëson identifikimin në kohën e duhur të një rritjeje të ndjeshme të rrezikut kreditor. Banka nuk duhet të kompromentojë këtë informacion duke grupuar instrumente financiare me karakteristika të ndryshme.

**6.1.3.4.5 Rezultat nga mesatarja e ponderuar**

Qëllimi i vlerësimit të humbjeve të pritshme të kredisë nuk është as për të vlerësuar humbjet në një skenar më të keq, e as në skenarin më të mirë. Në vend të kësaj, një vlerësim i humbjeve të pritshme të kredisë duhet të pasqyrojë gjithmonë mundësinë që humbja të ndodhë dhe mundësinë që humbja të mos ndodhë edhe nëse rezultati pritet të jetë pa humbje.

**6.1.4 Cilësia e kredisë**

Tabelat e mëposhtme japin informacion lidhur me cilësinë e kredisë për ato Aktive Financiare që maten me Kosto të Amortizuar:

Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	Më 31 dhjetor 2018					Më 31 dhjetor 2017
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	POCI	Totali	Totali
<b>Renditja e brendshme e Bankës</b>						
Standard	7,120,301	-	-	-	7,120,301	6,914,728
Monitorim i veçantë	-	-	-	-	-	-
Nënstandard	-	-	-	-	-	-
Të dyshimta dhe të humbura	-	-	-	-	-	-
<b>Teprica totale bruto</b>	<b>7,120,301</b>	-	-	-	<b>7,120,301</b>	<b>6,914,728</b>
Standard	169	-	-	-	169	-
Monitorim i veçantë	-	-	-	-	-	-
Nënstandard	-	-	-	-	-	-
Të dyshimta dhe të humbura	-	-	-	-	-	-
<b>Fondi i zhvlerësimit në total</b>	<b>169</b>	-	-	-	<b>169</b>	-
<b>Teprica totale bruto</b>	<b>7,120,132</b>	-	-	-	<b>7,120,132</b>	<b>6,914,728</b>

**Tirana Bank SHA****Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)****6.1.4 Cilësia e kredisë (vazhdim)**

Hua dhe paradhënie për bankat	Më 31 dhjetor 2018					Më 31 dhjetor 2017
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	POCI	Total	Total
<b>Renditja e brendshme e Bankës</b>						
Standard	17,454,093	-	-	-	17,454,093	26,544,252
Monitorim i veçantë	-	-	-	-	-	-
Nënstandard	-	-	-	-	-	-
Të dyshimta dhe të humbura	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendja në total (bruto)</b>	<b>17,454,093</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>17,454,093</b>	<b>26,544,252</b>
Standard	7,020	-	-	-	7,020	-
Monitorim i veçantë	-	-	-	-	-	-
Nënstandard	-	-	-	-	-	-
Të dyshimta dhe të humbura	-	-	-	-	-	-
<b>Fond i zhvlerësimit në total</b>	<b>7,020</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>7,020</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja në total (neto)</b>	<b>17,447,073</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>17,447,073</b>	<b>26,544,252</b>

Hua dhe paradhënie për klientët, neto	Më 31 dhjetor 2018					Më 31 dhjetor 2017
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	POCI	Total	Total
<b>Renditja e brendshme e Bankës</b>						
Standard	14,069,174	2,559,297	32,489	-	16,660,960	17,760,997
Monitorim i veçantë	93,250	502,376	1,318,171	-	1,913,797	2,394,475
Nënstandard	-	-	271,027	-	271,027	567,995
Të dyshimta dhe të humbura	-	-	5,610,295	-	5,610,295	6,648,318
<b>Gjendja në total (bruto)</b>	<b>14,162,424</b>	<b>3,061,673</b>	<b>7,231,982</b>	<b>-</b>	<b>24,456,079</b>	<b>27,371,785</b>
Standard	110,405	136,200	6,847	-	254,253	112,968
Monitorim i veçantë	11,186	68,453	200,790	-	298,611	224,385
Nënstandard	-	-	43,710	-	45,694	115,083
Të dyshimta dhe të humbura	-	-	2,824,191	-	3,012,422	2,882,118
<b>Fond i zhvlerësimit në total</b>	<b>121,591</b>	<b>204,653</b>	<b>3,075,539</b>	<b>-</b>	<b>3,610,980</b>	<b>3,334,554</b>
<b>Gjendja në total (neto)</b>	<b>14,040,833</b>	<b>2,857,020</b>	<b>4,156,443</b>	<b>-</b>	<b>20,845,099</b>	<b>24,037,231</b>

Sistemi i brendshëm i renditjes i përshkruar në shënimin 6.1.1 fokusohet më tepër në lidhjen e cilësisë me kredinë nga pikëpamja e kreditimit dhe aktiviteteve investuese. Fondi i zhvlerësimit i paraqitur në bilanc në fund të vitit përfitohet nga secila prej kategorive të brendshme të renditjes. Megjithatë, shumica e fondit të zhvlerësimit vjen nga dy renditjet e fundit. Tabela në vijim tregon përqindjen e zërave në bilancin e bankës në lidhje me huatë dhe paradhëniet dhe fondin e zhvlerësimit përkatës për secilën kategori:

**Tirana Bank SHA****Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)***6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)****6.1.4 Cilësia e kredisë (vazhdim)****Renditja e Bankës**

	2018		2017	
	Hua dhe paradhënie (%)	Niveli i fondit të zhvlerësimit (%)	Hua dhe paradhënie (%)	Niveli i fondit të zhvlerësimit (%)
Investim	-	-	-	-
Standard	68.13	1.53	64.89	0.64
Monitorim i veçantë	7.83	15.6	8.75	9.37
Nënstandard	1.11	16.86	2.08	20.26
Të dyshimta dhe të humbura	22.94	53.69	24.29	43.35
<b>Totali</b>	<b>100.00</b>	<b>14.77</b>	<b>100.00</b>	<b>12.18</b>

**6.1.5 Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor pa marrë parasysh kolateralin dhe garanci të tjera të kredisë**

	Ekspozimi maksimal	
	2018	2017
<b>Ekspozimet e rrezikut kreditor lidhur me aktivet në bilanc janë si më poshtë:</b>		
Mjete monetare dhe llogaritë me Bankën Qendrore	5,341,403	5,222,274
Hua dhe paradhënie për bankat	17,447,072	26,544,252
Hua dhe paradhënie për klientët, neto:		
Hua për individë:		
– Konsumatore/Overdraft	2,037,421	1,854,145
– Karta krediti	135,219	134,162
– Hipoteka	5,525,917	5,989,826
	<b>7,698,557</b>	<b>7,978,133</b>
Hua për korporata:		
– Klientë të mëdhenj	2,114,533	2,134,042
– Sipërmartje të vogla dhe të mesme (NVM)	11,032,009	13,925,057
	<b>13,146,542</b>	<b>16,059,098</b>
<b>Totali i huave dhe paradhënies për klientët, neto</b>	<b>20,845,099</b>	<b>24,037,231</b>
Aktive financiare të mbajtura me VDPPAP	23,857,367	15,343,098
<i>Ekspozimet e rrezikut kreditor lidhur me aktivet jashtë bilanci janë si më poshtë:</i>		
Letër garanci	305,799	329,461
Letër krediti	5,739	21,242
Angazhime huaje	6,379,489	4,794,011
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>74,120,127</b>	<b>76,291,569</b>

Tabela më sipër paraqet skenarin më negativ të ekspozimit të riskut të rrezikut për Bankën më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, pa marrë parasysh kolateralët e regjistruar apo siguruesit e tjerë të kredisë. Për aktivet në bilanc, ekspozimet e mësipërme bazohen në vlerën e mbetur të raportuar në bilanc.

## Tirana Bank SHA

### Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

#### 6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

##### 6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)

##### 6.1.5 Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor pa marrë parasysh kolateralin dhe garanci të tjera të kredisë

Drejtimi është i sigurtë tek aftësia e tij për të vazhduar të kontrollojë dhe mbështesë ekspozimin minimal ndaj rrezikut kreditor të Bankës që rezulton nga portofoli i saj i huave dhe paradhënies dhe instrumentet e borxhit si në vijim:

- 75.95 % e portofolit të huave dhe paradhënies kategorizohet në dy gradat kryesore të sistemit të brendshëm të renditjes (2017: 73.64%);
- Huatë për NVM, të cilat përfaqësojnë grupin më të madh në portofol, janë të mbrojtura me kolateral;
- 56.71% e portofolit të huave dhe paradhënies konsiderohen pa ditëvonesa dhe të pazhvlerësuar (2017: 51.98%); dhe
- Banka ka filluar zbatimin e një procesi më të vështirë përzgjedhje për dhënien e huave dhe paradhënies.

##### 6.1.6 Hua dhe paradhënie për klientët, neto

Huatë dhe paradhëniet përmbledhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018		31 dhjetor 2017	
	Hua dhe paradhënie për klientët, neto	Hua dhe paradhënie për bankat	Hua dhe paradhënie për klientët, neto	Hua dhe paradhënie për bankat
Pa ditëvonesa dhe të pa zhvlerësuar	13,868,578	17,454,093	14,228,527	26,544,252
Me ditëvonesa por jo të zhvlerësuar	4,342,895	-	5,698,629	-
Të zhvlerësuar individualisht	6,244,606	-	7,444,629	-
<b>Bruto</b>	<b>24,456,079</b>	<b>17,454,093</b>	<b>27,371,785</b>	<b>26,544,252</b>
Minus: provigjon për zhvlerësim	(3,610,980)	(7,020)	(3,334,554)	-
<b>Neto</b>	<b>20,845,099</b>	<b>17,447,073</b>	<b>24,037,231</b>	<b>26,544,252</b>

Informacion i mëtejshëm për provigjonet e zhvlerësimit për huatë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët paraqitet në shënimin 13 dhe 14.

##### *Hua dhe paradhënie pa ditëvonesa dhe të pa zhvlerësuar*

Cilësia e kredisë së portofolit të huave dhe paradhënies të cilat janë pa ditëvonesa dhe të pa zhvlerësuar vlerësohet në bazë të sistemit të brendshëm të renditjes së Bankës.

**Tirana Bank SHA****Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)***6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)****6.1.6 Hua dhe paradhënie për klientët, neto (vazhdim)**

	31 dhjetor 2018						
	Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto						
	<u>Individë</u>			<u>Korporata</u>		Hua dhe paradhënie për klientët	Hua dhe paradhënie për bankat
Konsumatore / Overdraft	Karta krediti	Hipoteka	Klientë të mëdhenj	Të vogla dhe të mesme			
Vlera bruto	1,597,041	115,864	3,650,573	2,003,215	6,501,885	13,868,578	17,454,093
Minus: fondi i zhvlerësimit	(17,318)	(4,507)	(30,110)	(11,999)	(105,387)	(169,320)	(7,020)
Vlera kontabël neto	1,579,723	111,357	3,620,463	1,991,216	6,396,498	13,699,258	17,447,073

  

	31 dhjetor 2017						
	Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto						
	<u>Individë</u>			<u>Korporata</u>		Hua dhe paradhënie për klientët	Hua dhe paradhënie për bankat
Konsumatore / Overdraft	Karta krediti	Hipoteka	Klientë të mëdhenj	Të vogla dhe të mesme			
Vlera bruto	1,390,534	116,201	3,494,560	1,567,418	7,659,815	14,228,527	26,544,252
Minus: fondi i zhvlerësimit	(18,887)	(6,590)	(21,489)	(356)	(14,413)	(61,736)	-
Vlera kontabël neto	1,409,421	122,791	3,516,049	1,567,774	7,674,228	14,290,263	26,544,252

Huatë dhe paradhëniet për klientët, neto në kategoritë nënstandarde dhe të dyshimta, u konsideruan të pa zhvlerësuar pasi Banka konsideroi rikuperueshmërinë e kolateralit për klientët në produktet hipotekë dhe hua konsumatore.

(a) *Hua dhe paradhënie me ditëvonesa por të pa zhvlerësuar*

Shuma bruto e huave dhe paradhënieve që janë me vonesë por të pa zhvlerësuar është:

(i) *Hua dhe paradhënie për klientët, neto*

**31 dhjetor 2018****Korporata dhe NVM**

Ditëvonesa deri në 90 ditë	1,469,186
Ditëvonesa 91-180 ditë	25,580
Ditëvonesa 181-360 ditë	44,124
Ditëvonesa mbi 360 ditë	528,931
<b>Totali</b>	<b>2,067,821</b>
<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	<b>1,852,040</b>
<b>Totali i huave dhe paradhënieve me ditëvonesa por të pa zhvlerësuar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>4,342,895</b>

**Tirana Bank SHA****Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)***6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)****6.1.6 Hua dhe paradhënie për klientët, neto (vazhdim)****31 dhjetor 2018**

	<u>Individë</u>			<b>Totali</b>
	<b>Konsumatorë / Overdraft</b>	<b>Hipoteka</b>	<b>Karta krediti</b>	
Ditëvonesa deri në 90 ditë	419,462	1,693,506	24,569	2,137,537
Ditëvonesa 91-180 ditë		85,893		85,893
Ditëvonesa 181-360 ditë		22,028		22,028
Ditëvonesa mbi 360 ditë		29,616		29,616
<b>Totali</b>	<b>419,462</b>	<b>1,831,043</b>	<b>24,569</b>	<b>2,275,074</b>
<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	<b>279,003</b>	<b>1,791,636</b>	<b>-</b>	<b>2,070,639</b>

**31 dhjetor 2017**

	<u>Korporata dhe NVM</u>
Ditëvonesa deri në 90 ditë	2,309,925
Ditëvonesa 91-180 ditë	60,407
Ditëvonesa 181-360 ditë	53,110
Ditëvonesa mbi 360 ditë	609,224
<b>Totali</b>	<b>3,032,666</b>
<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	<b>2,988,402</b>
<b>Totali i huave dhe paradhënies me ditëvonesa por të pa zhvlerësuar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>5,698,629</b>

**31 dhjetor 2017**

	<u>Individë</u>			<b>Totali</b>
	<b>Konsumatorë / Overdraft</b>	<b>Hipoteka</b>	<b>Karta krediti</b>	
Ditëvonesa deri në 90 ditë	402,596	2,052,697	26,001	2,481,295
Ditëvonesa 91-180 ditë	-	99,524	-	99,524
Ditëvonesa 181-360 ditë	-	17,947	-	17,947
Ditëvonesa mbi 360 ditë	-	67,198	-	67,198
<b>Totali</b>	<b>402,596</b>	<b>2,237,366</b>	<b>26,002</b>	<b>2,665,964</b>
<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	<b>313,852</b>	<b>2,209,786</b>	<b>1,918</b>	<b>2,525,556</b>

*Hua dhe paradhënie për bankat*

Nuk ka hua dhe paradhënie për bankat me ditëvonesa por jo të zhvlerësuar deri më 31 dhjetor 2018 (2017: zero).

*(b) Hua dhe paradhënie të zhvlerësuar**Hua dhe paradhënie për klientët, neto*

Detajimi i shumës bruto të huave dhe paradhënies të zhvlerësuar individualisht sipas kategorisë së bashku me vlerën e drejtë të kolateralëve përkatës të regjistruar si siguri për bankën janë si në vijim:



**6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

**6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

**6.1.6 Hua dhe paradhënie për klientët, neto (vazhdim)**

	<b>Konsumatorë dhe karta kreditit</b>	<b>Hipoteka</b>	<b>Korporata dhe NVM</b>	<b>Totali</b>
<b>31 dhjetor 2018</b>				
Hua të zhvlerësuara individualisht	5,068	46,270	5,457,442	5,508,779
<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	-	<b>44,087</b>	<b>4,311,578</b>	<b>4,355,665</b>
<b>31 dhjetor 2017</b>				
Hua të zhvlerësuara individualisht	1,205	95,777	6,715,518	6,812,500
<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	-	<b>76,452</b>	<b>6,302,233</b>	<b>6,378,685</b>

Detajimi i shumës bruto të huave dhe paradhënieve të zhvlerësuara në mënyrë kolektive sipas kategorisë, së bashku me vlerën e drejtë të kolateralëve përkatës të regjistruar si siguri për bankën janë si në vijim:

	<b>Konsumatorë dhe karta kreditit</b>	<b>Hipoteka</b>	<b>Korporata dhe NVM</b>	<b>Totali</b>
<b>31 dhjetor 2018</b>				
Hua të zhvlerësuara kolektivisht	228,810	302,695	204,322	735,827
<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	<b>72,544</b>	<b>267,462</b>	<b>100,773</b>	<b>440,779</b>
<b>31 dhjetor 2017</b>				
Hua të zhvlerësuara kolektivisht	243,423	363,849	24,857	632,129
<b>Vlera e drejtë e kolateralit</b>	<b>101,229</b>	<b>351,065</b>	<b>12,086</b>	<b>464,380</b>

Vlera e drejtë e shpalosur e kolateralit përcaktohet nga vlerësuesit lokalë të çertifikuar dhe përfaqëson vlerën e realizuar nga pronarët ligjorë të aktiveve. Drejtimi i konsideron kreditë e mbuluara me kolateral për kreditë e korporatave si të zhvlerësuara, sepse përvoja tregon se një pjesë e konsiderueshme e kolateralit në kreditë e korporatave nuk mund të zbatohet për shkak të vështirësive administrative dhe ligjore të tilla si ulja e vlerës së kolateralit në ankandet e administruara nga zyra e përmbarimit, Të domosdoshme për të zbatuar kolateralet. Rezerva e zhvlerësimit pasqyron probabilitetin që Drejtimi nuk do të jetë në gjendje të zbatojë të drejtat e tij dhe të riposedojë kolateralin në kreditë e dështuara. Pavarësisht vështirësive në zbatimin e riposedimit të kolateralit, Drejtimi i Bankës do të ndjekë me forcë borxhet e mbetura me të gjitha mjetet e mundshme në dispozicion të tyre. Nuk ka hua dhe paradhënie individuale të zhvlerësuara për bankat më 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Kreditë e rinegociuara më 31 dhjetor 2018 janë 29 raste, në shumën 245,003 mijë Lekë (2017: 55 raste, në shumën 729,392 mijë Lekë).

**6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****6.2 Rreziku i tregut**

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit dhe normat e kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të detyruesit/emetuesit) do të ndikojnë të ardhurat e bankës ose vlerën e pjesëmarrjeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i Drejtimit të rrezikut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimeve të rrezikut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin e rrezikut.

Çështjet e rrezikut të tregut ndiqen vazhdimisht dhe rregullisht nga Komiteti i Menaxhimit të Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO).

**6.2.1 Rreziku i kursit të këmbimit**

Banka është e ekspozuar kundrejt rrezikut të monedhës përmes transaksioneve në monedhë të huaj. Banka sigurohet që ekspozimi neto të ruhet në një nivel të pranueshëm duke blerë dhe shitur monedhë të huaj me kursin aktual kur kjo është e nevojshme për të rregulluar çrregullimet e përkohshme. Drejtimi vendos limite ndaj nivelit të ekspozimit sipas monedhës, të cilat monitorohen çdo ditë.

**Përqendrimet e rrezikut të kursit të këmbimit – instrumente financiarë brenda dhe jashtë bilancit:**

<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>Monedha të tjera</b>	<b>LEK</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktive</b>					
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	3,206,455	398,400	23,382	3,491,895	7,120,132
Hua dhe paradhënie për bankat	15,758,362	1,032,755	655,956	-	17,447,073
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	10,610,595	827,426	15,562	9,391,516	20,845,099
Aktive financiare të mbajtura me VDPPAP	5,886,887	-	-	17,970,480	23,857,367
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>35,462,299</b>	<b>2,258,581</b>	<b>694,900</b>	<b>30,853,891</b>	<b>69,269,671</b>
<b>Detyrime</b>					
Detyrime ndaj bankave	207,133	-	13,089	2,397,048	2,617,270
Detyrime ndaj klientëve	23,647,481	2,199,825	663,950	30,653,624	57,164,880
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>23,854,614</b>	<b>2,199,825</b>	<b>677,039</b>	<b>33,050,672</b>	<b>59,782,150</b>
<b>Pozicioni në monedhë neto në bilanc</b>	<b>11,607,684</b>	<b>58,755</b>	<b>17,861</b>	<b>(2,196,780)</b>	<b>9,487,520</b>
<b>Zërat jashtë bilancit</b>	<b>4,895,848</b>	<b>40,431</b>	<b>611,519</b>	<b>1,143,228</b>	<b>6,691,026</b>
<b>Ndjeshmëria nëse kurset e këmbimit rriten me 5%</b>	<b>(6,953)</b>	<b>(153)</b>	<b>604</b>		<b>(6,502)</b>
<b>Ndjeshmëria nëse kurset e këmbimit zvogëlohen me 5%</b>	<b>6,953</b>	<b>153</b>	<b>(604)</b>		<b>6,502</b>

Banka menaxhon ekspozimin e saj në monedhë të huaj duke marrë parasysh që kapitali i saj së bashku me primin janë të emërtuar në Euro. Ndjeshmëria e paraqitur në tabelën e mësipërme llogarit rritjen / (rënien) e fitimit para tatimit nëse në datën e raportimit, kursi i këmbimit të Lekut rritet / (bie) me 5% në lidhje me monedhën e huaj respektive, duke i mbajtur të gjitha variablat e tjera konstante.

**Tirana Bank SHA****Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)***6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)****6.2.1 Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2017	EUR	USD	Monedha të tjera	LEK	Totali
<b>Aktive</b>					
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	3,202,924	411,662	18,214	3,281,928	6,914,728
Hua dhe paradhënie për bankat	24,738,436	1,276,316	64,625	464,875	26,544,252
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	13,527,180	1,063,069	17,802	9,429,180	24,037,231
Investime të mbajtura me VDPPAP	2,998,893	-	-	12,344,205	15,343,098
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>44,467,433</b>	<b>2,751,047</b>	<b>100,641</b>	<b>25,520,188</b>	<b>72,839,309</b>
<b>Detyrime</b>					
Detyrime ndaj bankave	135,922	-	15,954	1,100,406	1,252,282
Detyrime ndaj klientëve	25,956,351	2,539,180	528,443	31,933,172	60,957,146
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>26,092,273</b>	<b>2,539,180</b>	<b>544,397</b>	<b>33,033,578</b>	<b>62,209,428</b>
<b>Pozicioni në monedhë neto në bilanc</b>	<b>18,375,160</b>	<b>211,867</b>	<b>(443,756)</b>	<b>(7,513,390)</b>	<b>10,629,881</b>
<b>Zërat jashtë bilancit</b>	<b>4,704,308</b>	<b>116,848</b>	<b>479,840</b>	<b>271,545</b>	<b>5,572,541</b>
<b>Ndjeshmëria nëse kurset e këmbimit rriten me 5%</b>	<b>(8,098)</b>	<b>(49)</b>	<b>999</b>		<b>(7,148)</b>
<b>Ndjeshmëria nëse kurset e këmbimit zvogëlohen me 5%</b>	<b>8,098</b>	<b>49</b>	<b>(999)</b>		<b>7,148</b>

**6.2.2 Rreziku i normës së interesit**

Veprimtaria e Bankës është subjekt i rrezikut të ndryshimit të normave të interesit deri në masën që aktivet që fitojnë interes (duke përfshirë investimet) dhe detyrimet që mbartin interes maturojnë ose ndryshojnë normat në kohë ose shuma të ndryshme. Në rastin e aktiveve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, banka ekspozohet edhe ndaj rrezikut të interesit bazë, e cila është diferenca në karakteristikat e riçimit të indekseve të ndryshme të përdorura, si norma e kursimit, LIBOR dhe llojet e ndryshme të interesit.

Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi, deri në masën që nivelet në normat e tregut të interesit janë në përputhje me strategjinë e biznesit të bankës.

Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut aktiv-detyrim drejtohen në kontekst të ndjeshmërisë së bankës ndaj ndryshimeve në normat e interesit.

Në zvogëlimin e ambienteve të normave të interesit, marzhet e fituara do të zvogëlohen kur normat e interesit për detyrimet do të zvogëlohen me përqindje më të ulët kur krahasohen me normat e interesit për aktivet. Megjithatë, ndikimi real do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë ekonominë, ambientin dhe nivelin e inflacionit.

**Tirana Bank SHA****Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)***6 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)****6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)****6.2.2 Rreziku i normës së interesit (vazhdim)**

Banka mundohet të zvogëlojë riskun e normës së interesit duke monitoruar datat e riçimitit të aktiveve dhe detyrimeve të veta. Për më tepër, Banka ka të drejta kontraktuale për të rishikuar çdo tre muaj normat e interesit në pjesën më të madhe të portofolit të kredisë.

